

Pse Kosovës i nevojitet migrimi?



Ky është ribotim i raportit të ESI-t: *Cutting the Lifeline* (2006)

me hyrje të re

“Make it in Germany?”

Raporti është shkruar në GJUHËN ANGLEZE, përkthyer në GJUHËN SHQIPE

23 prill 2015
Berlin – Prishtinë

“MAKE IT IN GERMANY”? (2015)

Nga portali i Qeverisë Gjermane, *Make it in Germany*:

“Gjermania ka mungesë të punëtorëve të kualifikuar në profesionin që ju dëshironi të ndiqni. Këtu mund të gjeni një listë të vendeve të lira të punës... Ju është ofruar një vend pune? Kualifikimi juaj është pranuar të jetë ekuivalente me kualifikimin në Gjermani? Këtu mund të gjeni më shumë informata rreth njohjes së kualifikimeve tuaja profesionale. Ju duhet të aplikoni për njohje të kualifikimeve nga shteti juaj... Për shkak të shtimit të numrit të personave të moshuar, në Gjermani është rritur edhe nevoja për kujdestarë. Parashikohet që deri në vitin 2025 do të ketë mungesë të deri 152,000 kujdestarëve.”

“*Make it in Germany*”

www.make-it-in-germany.com/en

Në vitin 2005 dhe 2006, ESI bëri një studim mbi varfërinë rurale, migrimin dhe remitancat në Kosovë dhe botuam raportin e titulluar “Cutting the Lifeline.”¹ Raporti tregon që migrimi – veçanërisht i djemve të rinj – ka qenë i domosdoshëm për mbijetesën ekonomike të gjeneratave të tëra. Raporti nënvizon se mbyllja e dyerve evropiane për migrim të rregullt të punës pas vitit 1999, la *bashkimin familjar* si të vetmën rrugë ligjore për migrim.²

Raporti përshkruan në detaje realitetin ekonomik të dy fshatrave: Cërrcës, fshat që gjendet në veri-perëndim të Kosovës në kufi me Shqipërinë, dhe Lubishtës, që ndodhet në jug-lindjen malore. Këto dy fshatra reflektojnë situatën ekonomike dhe sociale në gjithë Kosovën dhe gjetjet tona treguan se zhivillimi ekonomik nuk është i mundur pa migrimin e një numri të konsiderueshëm të banorëve nga fshatra si këto, për të gjetur punë, trajnim dhe kapital gjetiu.

Një dekadë pas përfundimit të studimit tonë pak gjëra kanë ndryshuar. Në vitin 2005, anketa e fuqisë punëtore tregoi që vetëm 29% të qytetarëve të moshës së punës (15 deri 64 vjeçare) punojnë.³ Në vitin 2013, anketa e fuqisë punëtore doli me numra gati identik: vetëm 28.4% të qytetarëve të moshës së punës punojnë.⁴ Numrat më dramatik janë ata për punësimin e grave: në vitin 2005, vetëm 12% e grave punonin ndërsa në vitin 2013 ky numër ishte ngritur pak në 12.9%. Kjo do të thotë se afër 90% të grave të moshës së punës nuk punojnë dhe nuk kanë asnjë perspektivë për punë në të ardhmen.

Dy fshatrat në vitin 2005

Cërrcë

1,311 banorë, 766 në moshë të punës, **231** kanë të ardhura të rregullta. Nuk ka mbetur asnjë nga industritë e vjetra në qytet në rrethinë. Bujqësia komerciale ka dështuar. Burimet më të mëdha të të ardhurave janë ndërtimet e rastit dhe sektori publik.

Vetëm 35 gra janë të punësuar (nivel punësimi të grave prej 9%). Një ekonomi familjare posedon mesatarisht 1.1 hektar tokë. Vetëm dy fermerë kanë më shumë se 10 lopë. Fermat familjare prodhojnë për konsum vetanak, kryesisht grurë për të gatuar bukë; nuk ka ndonjë specializim apo teknika të reja bujqësore.

¹ ESI, *Cutting the Lifeline*, 2006.

² Po aty.

³ Agjencia e Statistikave të Kosovës, *Statistikat e tregut të punës 2005*, 2006, f. 14.

⁴ Agjencia e Statistikave të Kosovës, *Rezultatet e anketës së fuqisë punëtore 2013*, 2014, f. 11.

Një e treta e popullësisë së Cërccës (607) jetojnë jashtë vendit dhe 14 nga 30 traktorët në fshat janë blerë përmes remitancave. 100 familje posedojnë vetura: 45 prej tyre janë blerë përmes remitancave.

Lubishtë

1,534 banorë, 842 në moshë të punës, **134** kanë të ardhura të rregullta. Vetëm dy gra janë të punësuar – më pak se 1%. Një fermer tipik ka 5 viça, tri lopë qumështore dhe një ka. Ai mund të prodhojë mjaft miell për të gatuar bukë për dhjetë muaj. Shpenzimet bujqësore janë të larta. Atij do t'i nevojitej më shumë tokë për të mbijetuar nga bujqësia. Për blerje të tokës i duhen kursime të cilat ai nuk mund t'i mbledhë nga shitjet bujqësore. Të ardhurat nga bujqësia në Kosovë janë më të ulëta se investimet.

Në Lubishtë 91 nga 97 traktorët e fshatit janë blerë me para të fituara jashtë vendit. 147 shtëpi posedojnë vetura: 137 nga këto janë blerë përmes remitancave.

Sot nuk ka pothuajse asnjë vend pune nëpër qytete që do t'u mundësonte njerëzve punësim perderisa banojnë në fshatrat e tyre. Dhe vendet e punës që ekzistojnë, nuk paguajnë mjaft për t'u mundësuar atyre të zhvendosen në qytet. Që do të thotë se një banor fshati ka më shumë llogari të kërkojë punë në Gjermani se sa në Prishtinë, Pejë apo Prizren, përkundër shpenzimeve dhe vështirësive të qarta që vijnë me migrimin.

Rekomandimet – atëherë dhe tani

Në vitin 2006 ESI ka bërë katër rekomandime për politikëbërësit evropian dhe kosovarë:

1. BE duhet të shqyrtojë mundësitë për migrim të rregullt nëse dëshiron të ndihmojë zhvillimin ekonomik të Kosovës.

“Ky raport përmban një porosi të padëshiruar për shtetet anëtare të BE-së: nuk ka kuptim të investohen qindra miliona euro në stabilizimin e Kosovës, dhe në të njëjtën kohë të mbyllen dyert për migrim të rregullt.”

“Evropianizimi duhet të nënkuptojë edhe qasjen në tregun evropian të punës, përndryshe do të mbetet veçse një slogan. Politikat aktuale të BE-së – për të vazhduar investimin e qindra miliona eurosh për ta stabilizuar Kosovën dhe Evropën jug-lindore, pa një politikë të qëndrueshme për zhvillim ekonomik dhe migrim – është e pakuptimt.”

2. Hapja e mundësive për migrim të rregullt do të parandalonte migrimin jo të rregullt dhe do të kontribonte pozitivisht në tregjet e punës së Kosovës dhe Evropës.

“Shtetet evropiane duhet të punojnë me institucionet e Kosovës për të krijuar skema të migrimit për punësim, politikisht të pranueshme për vendet e Bashkimit Evropian që kanë nevojë për fuqi punëtore. Kjo nënkupton ndërmarrjen e hapave konkrete për t'u ndihmuar kosovarëve të kenë qasje në tregjet e punës së BE-së.”

3. Kosova duhet t'i vendosë politikat e migrimit për punë në qendër të çdo debati për zhvillim ekonomik. Kjo kërkon ndërtim të kapaciteteve analitike dhe politikbërëse, të modeluara në vendet e tjera me histori migrimi, si Irlanda apo Polonia:

“Kosova duhet të themelojë një institut kombëtar për të studiuar aspektet ekonomike, sociale dhe ligjore të migrimit. Instituti do të duhej të fokusohet jo vetëm në Gjermani,

Austri dhe Zvicërr, që janë destinacionet kryesore për migruesit nga Kosova, por në të gjithë tregun Evropian të punës. Ai duhet të studiojë përvojat me migrim për punë nga e gjithë bota.”

4. Kosova duhet të ndërtojë politikatat arsimore dhe sociale duke patur çështjen e migrimit parasysh. Kosovarët me aftësi të ngritura profesionale dhe gjuhësore do të jenë më të sukseshëm në gjetjen e vendeve të lira punës. Duke patur aftësi profesionale që përputhen me kërkesat e vendeve të punës, ata do të gjejnë punë që paguhen më mirë, duke siguruar kështu mirëqenie ekonomike për vete dhe familjet e tyre, por duke i kontribuar edhe shtetit ku do të punojnë. *Instituti Kosovar i Migrimit* duhet “t’i informojë institucionet arsimore dhe politikëbërësit në Kosovë rreth nevojave të tregjeve evropiane të punës në mënyrë që të përkthehen ato në arsimim dhe trajnim.”

Zhvillimet e fund vitit 2014 dhe fillim vitit 2015 kanë alarmuar politikëbërësit në BE-së. Më shumë se se 100,000 kosovarë kaluan kufirin e BE-së në mënyrë jo të rregullt, shpesh duke përdorur sistemin a azilit si mënyrën e vetme për të siguruar qëndrim në BE. Ky raport ofron disa përgjigje për politikëbërësit evropianë që pyesin për shkaqet e këtij ekzodi.

Ka mënyra konstruktive për t’iu përgjigjur kësaj sfide të re të migrimit. Ta marrim shembull Gjermaninë, destinacionin kryesor të migruesëve kosovarë sot. Sipas *Der Spiegel*, aktualisht janë rreth 50 milionë punëtorë në Gjermani por në 15 vitet e ardhshme do të jenë rreth 10 milionë më pak.⁵ Kjo të të thotë se rreth 10 milionë vende të punës do të lirohen gjatë 15 viteve të ardhshme. Ndërsa Kosova, sipas trendeve të deritanishme, nuk do të arrijë të krijojë vende të reja të punës për t’i akomoduar të gjithë ata të rinj që hyjnë në treg të punës çdo vit. Kështuqë, nëse 150,000 të rinj që sot jetojnë në Kosovë do t’i zinin një pjesë vendeve të punës në Gjermani, përmes migrimit të rregullt deri në vitin 2030, të dy vendet do të përfitonin.

Një synim i tillë – t’a quajmë **vizioni “150,000 deri 2030”**– kërkon reforma serioze të sistemit të arsimit në Kosovë. Skemat e trajnimit për të bërë të mundshëm një migrim të tillë të rregullt nuk ekzistojnë për pjesëm dërrmuese të popullsisë rurale në Kosovë. Duket se një gjeneratë e tërë e grave të reja nëpër fshatra do të mbesin ekonomikisht të varura nga burrat e tyre dhe kurrë nuk do të punojnë jashtë shtëpisë. Vetëm ky fakt është i mjaftueshëm të parandalojë ekonominë e Kosovës të arrijë së paku nivelin e ekonomive fqinje.

Numri i nxënësve në shkollat profesionale në Kosovë vitin e kaluar ishte 55,800. Sa prej tyre do të mund të punojnë punët për të cilat ka kërkesë në ekonominë e BE-së? Sa prej tyre janë duke e mësuar një gjuhë të huaj? Më 16 Prill 2015, Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare nënshkroi një memorandum bashkëpunimi me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale për të dërguar të rinj mbi moshën 18 vjeçare në Gjermani për t’u trajnuar në fusha përkatëse dhe në të njëjtën kohë për të punuar në kompani gjermane. Ky është një hap i vogël fillestar. Në mënyrë që këto lloj projektesh të adresojnë sfidat madhore sociale të adresuara nga ky raport, nevojitet një debat më i gjerë politik rreth së ardhmes së migrimit për Kosovën.

Ky debat tashmë ka filluar në mediat gjermane⁶ dhe ka ardhur koha të zhvillohet edhe në Kosovë.

⁵ Der Spiegel, “2030 Es kommen härtere Jahre”, 14 Mars 2015.

⁶ Frankfurter Allgemeine Zeitung, “Einwanderung aus dem Kosovo Willkommen in Deutschland!”, 25 Shkurt 2015.

“Njerëzit nuk besojnë në potencialin e individëve për t’i ikur *status quo*-së dhe për të sjellë ndryshime. Ata supozojnë se një ditë të gjithë dhe përnjëherë do të ndryshojnë mënyrën si jetojnë; se të gjithë prindërit njëkohësisht do të vendosin që t’i shkollojnë vajzat e tyre dhe do t’u lejojnë djemve të tyre t’i zgjedhin gratë vetë. Askush nuk beson se një individ apo një familje mund të sfidojë fuqinë e opinionit më të gjerë publik.”

Janet Reineck, *E kaluara si refugjate*

~ *Përmbajtja* ~

| | | |
|------|----------------------------------------------------------------|----|
| I. | HYRJE (2006) | 2 |
| II. | SI U NDAL MIGRIMI | 3 |
| | A. Djemtë e rinj në trena | 3 |
| | B. Deportimet | 4 |
| | C. Ekonomia morale e të dërguarit të parave | 6 |
| | D. Si i mbajti migrimi gratë në shtëpi | 8 |
| III. | PËRSE KA NGECUR KOSOVA | 10 |
| | A. Një fshat i varfër dhe familjet më të mëdha në Evropë | 11 |
| | B. Fshati i Rugovës dhe mungesa e tokave | 13 |
| | C. Si dështoi komunizmi | 15 |
| | D. Regjionet e braktisura nga punëtorët | 19 |
| | E. Gratë rurale pa të drejta | 22 |
| IV. | KUR PATRIARKATI SHPARTALLOHET | 24 |
| | A. Familjet, mbijetesë, mirëqenia | 24 |
| | B. Si shpartallohet patriarkati | 25 |
| V. | KONKLU DIM – FUNDI I NJË EPOKE? | 28 |
| | SHTOJCA I – Cërrcë në shifra (2005) | 30 |
| | SHTOJCA II – Lubishta në shifra (2005) | 32 |
| | SHTOJCA III – Një fshat i pasur dhe një i varfër | 34 |
| | SHTOJCA IV – METODOLOGJIA E HULUMTIMIT TË FSHATRAVE | 35 |

I. HYRJE (2006)

Debatet politike aktuale në Kosovë nuk prekin çështjen më të rëndësishme për zhvillimin e Kosovës sot: ndikimin e migrimit. Si rezultat i kësaj, një nga ndryshimet më destabilizuese që do të ketë ndikim mbi shoqërinë e Kosovës për gjenerata me radhë – përfundimi i epokës së migrimit masiv – rrezikon të mos trajtohet fare nga ata që janë përgjegjës për promovimin e stabilitetit dhe prosperitetit në Kosovë.

Ky raport synon të vendosë migrimin në qendër të debateve lidhur me të ardhmen e Kosovës. Ai analizon ndikimin e ndërprerjes së migrimit masiv që nga viti 1999, duke analizuar dy fshatra tipike për të ilustruar trendet ekonomike që janë vënë në lëvizje në Kosovën rurale. Teza bazike e këtij shkrimi pa dyshim do të vë në siklet politikëbërësit evropianë: nëse Kosovarët e rinj nuk do të mund të shkojnë më në Evropë si punëtorë migrues kriza aktuale në Kosovën rurale ka gjasa të thellohet.

Dilema themelore lidhur me Kosovën rurale nuk është gjë e re. Në vitin 1979, Banka Botërore shkruante se varfëria në Jugosllavi është në thelb rurale. Edhe pse vlerësonte se ka shpresë për rritje të punësimit në pjesën më të madhe të rajoneve më pak të zhvilluara të vendit, ajo nuk shihte shumë perspektivë për ndryshime në Kosovë.

“Përrjashtim përbën Kosova e cila nuk është në gjendje të absorbojë rritjen e fuqisë punëtore të saj, edhe nëse realizohen supozimet më optimiste dhe arrihen caqet e planit zhvillimor.”⁷

Që nga ajo kohë popullsia e Kosovës ka vazhduar të rritet me shpejtësi, por as numri i vendeve të punës e as disponueshmëria e tokës bujqësore nuk e kanë ndjekur këtë trend të rritjes. Pa perspektivë reale të punësimit brenda Kosovës dhe pa përkrahje, apo me fare pak përkrahje nga shteti, gjenerata të tëra të kosovarëve kanë marrë rrugën e migrimit drejt Gjermanisë apo Zvicrës, shpesh me shumë hezitime, vetëm e vetëm për ta siguruar mbijetesën e tyre dhe të familjeve të tyre.

Aktualisht shtetet anëtare të BE-së i kanë vënë kufizime migrimit për punësim. Shtetet të cilat kanë lejuar mobilitet në punësim, siç janë Irlanda dhe Mbretëria e Bashkuar, janë duke rishqyrtuar vendimet e veta, me gjithë dëshmitë për përfitimet ekonomike që ky mobilitet ua ka sjellë. Kundrejt këtij sfondi politik, sugjerimi që Evropa duhet të reflektojë seriozisht lidhur me migrimin e fuqisë punëtore nga Kosova nuk dë të pranohet lehtë. Por, alternativa e kësaj, përpjekja që shoqëria e Kosovës të stabilizohet pa një dinamikë pozitive ekonomike, është e pamundur. Ministrinë e punëve të jashtme të Evropës janë duke u përballë me sfidën e sigurimit të një zgjidhjeje të qëndrueshme politike për Kosovën. Në anën tjetër, objektiv kryesor i ministrave të punëve të brendshme të Evropës është që të parandalohet migrimi i mëtejshëm nga Ballkani. Këto dy objektiva në thelb nuk përkojnë me njëra-tjetrën. Ky raport vlerëson se çka nënkupton kjo mungesë konsistence për politikën evropiane dhe ato të institucioneve të Kosovës.

Por, ky raport përmban një porosi të palakmueshme edhe për politikëbërësit kosovarë. Në periudhën e pasluftës, politikëbërësit kanë qenë të kënaqur me nocionin se remitancat nga diaspora zemërgjerë e shqiptarëve të Kosovës mund t'i mbajnë gjallë viset rurale të Kosovës, përkundër mungesës së politikave të mirëfillta bujqësore dhe të zhvillimit rural. Megjithatë, migrimi masiv dhe remitancat nuk e kanë promovuar zhvillimin në viset rurale të Kosovës.

⁷ Martin Schrenk, Cyrus Ardalan dhe Nawal A. El Tatawy, Yugoslavia. Self-management Socialism and the Challenges of Development. A World Bank Country Economic Report, f. 284f.

Ato thjeshtë e kanë ruajtur *status quo*-në. Duke bërë këtë, ato kanë ndihmuar në ruajtjen e njëjës prej institucioneve më të vjetra dhe më konzervative të Evropës: familjen e madhe patriarkale.

Ekonomitë familjare tradicionale – të përbëra nga disa familje nukleare, kryesisht prindërit me djemtë e tyre dhe familjet e djemve nën një kulm – dikur ishin të përhapura në ish-Jugosllavi por tani gjenden vetëm në Kosovë. Ky organizim familjar u ka ndihmuar shqiptarëve të Kosovës që të mbrohen nga institucionet shtetërore, kryesisht armiqësore ndaj shqiptarëve. Në anën tjetër, ky organizim familjar ka penguar punësimin e grave (sot Kosova ka numrin më të vogël të grave të punësuar në Evropë), ka investuar pak në arsim dhe ka penguar ndërmarrësinë. Por, familja tradicionale është duke u shpërbërë dhe pasojat e kësaj shpërbërjeje për shoqërinë rurale do të jenë marramendëse.

Kosovës urgjentisht i nevojitet migrimi. Një shoqëri që zgjidhë problemet e veta me fuqinë e tepërt punëtore përmes migrimit, siç ka bërë Kosova për dekada me radhë, patjetër do të shndërrohet në shoqëri jostabile posa t’i jetë mbyllur rruga e migrimit. Pra Kosovës i nevojitet një revolucion ekonomik dhe shoqëror për fshatrat e veta që të mos mbështetet vetëm në migrim. Pikënisja e këtij revolucioni duhet të jetë reflektimi mbi trendet ekonomike dhe sistemet e vlerave që i kanë mbajtur të gjalla strukturat e familjes së madhe patriarkale. Duhet të reflektohet mbi statusin e grave nga viset rurale dhe mbi rolin që Qeveria e Kosovës mund ta luajë në rrënimin e këtij rrethi vicioz të mungesës së zhvillimit ekonomik dhe papunësisë.

II. SI U NDAL MIGRIMI

A. Djemtë e rinj në tren

Migrimi ka qenë tipar që ka definuar shoqërinë e Kosovës për dekada të tëra, ngjashëm me historinë e brezave të tërë të irlandezëve, grekëve apo spanjollëve (apo në shekujt paraprakë gjermanëve apo suedezëve). Përgjatë tërë shekullit XX, familjet rurale të Kosovës kanë mbijetuar e nganjëherë edhe kanë përparuar falë faktit që meshkujt e tyre kanë shkuar jashtë të punojnë si *gastarbajterë*, duke qëndruar larg familjeve për pjesën më të madhe të kohës. Ata punonin në ndërtimtari, bujqësi apo si shitës akulloresh. Në të kaluarën më të largët, ata merrnin rrugën e Stambollit dhe Selanikut; më pas, në epokën socialiste, rrugën e Zagrebit apo Beogradit (duke fituar reputacion në ish-Jugosllavi për ëmbëltoret më të mira në vend). Në fund të viteve të 60-ta, rruga e migrimit i dërgoi ata më në perëndim, për tu shërbyer nevojave të ekonomive evropiane në rritje dhe kërkesës për *gastarbajterë*.

Punëtorët migrues nga Kosova nuk i kanë humbur lidhjet me familjet e tyre në fshatrat e Kosovës – së paku jo gjenerata e parë. Ata jetonin nga shumë vetë në një banesë të vetme në Shtutgart apo Gjenevë, duke kursyer paratë për t’ua dërguar familjeve të tyre. Remitancat që ata dërgonin ndihmonin në gjenerimin e parave të gatshme të cilat familjet e tyre i përdornin për të blerë traktorë apo bagëti, për të paguar dasmat apo për të shtuar ndonjë kat të shtëpisë për tu krijuar hapësirë gjeneratës së re. Sipas fjalëve të antropologes amerikane që ka studiuar Kosovën në fund të viteve të 80ta, stória tipike e familjes rurale të Kosovës në vitin 1988 dukej si në vijim:

“një djalë që është i lirë deri në ditën kur e gjen veten në tren, në udhëtim tridhjetë orësh drejt veriut, drejt Zvicrës apo Austrisë, me qëllim të gjetjes së një vendi të punës, çfarëdo

pune qoftë, për të fituar para të mjaftueshme për të paguar satenin dhe arin që do ta bartë nusja të cilët ia kanë gjetur prindërit e tij.”⁸

Gjatë viteve të 70ta dukej sikur përfitimet e industrializimit socialist mund të ofrojnë alternativë për migrimin. Arsimi filloi të konsiderohet si rrugë drejt sigurisë ekonomike, kësisoj popullariteti i tij filloi të rritet shumë madje edhe mes familjeve më tradicionale. Vende të reja të punës u hapën në administratë publike dhe ndërmarrje shoqërore. Për rreth një dekadë, disa shqiptarë të Kosovës kishin mundësi të punësoheshin në Prishtinë, Prizren apo Pejë. Gratë mund të shpresonin se do të gjejnë burra që do të mbesin në Kosovë; disa madje edhe aspironin të gjejnë vende pune për vete.

Kjo periudhë e shkurtër kohore nuk zgjati shumë. Kriza e socializmit jugosllav nga fillimi i 80ave solli fundin e krijimit të vendeve të reja të punës në qendra urbane; represioni i Millosheviqit ktheu prapa çfarëdo progresi që ishte arritur deri atëherë. Nga fundi i 80ave, emigrimi sërish dukej se do tu siguronte familjeve shqiptare të Kosovës shpresë për avancim financiar. Largimet në drejtim të Evropës perëndimore, kryesisht në drejtim të Gjermanisë e Zvicrës, u shtuan dramatisht. Deri në fund të viteve të 90ta supozohet se rreth gjysmë milioni shqiptarë të Kosovës, rreth 25% të popullsisë, jetonin jashtë vendit.

B. Deportimet

Në fillim të viteve të 90ta, kur në Kosovë u përshkallëzuan dhuna dhe represioni, shqiptarët e Kosovës që arrinin në Evropë merrnin statusin e refugjatëve politikë e jo punëtorëve migrues. Ata të cilët arrinin në Gjermani merrnin “leje tolerimi” (Duldung), por jo azil politik. Kjo u lejonte qëndrimin pa u dashur të vërtetojnë se kanë qenë të përndjekur individualisht, por i kushtëzonte ata me deportim në momentin kur gjendja në Kosovë do të ndryshonte.

Intervenimi i NATO-s në vitin 1999 dhe fundi i kontrollit të Serbisë mbi Kosovën shënoi fundin e tolerimit të refugjatëve shqiptarë nga Kosova. Mbi njëqindmijë shqiptarë të Kosovës u kthyen vetëm nga Gjermania. Njëkohësisht, migrimi legjitim u kufizua vetëm në programet e bashkimeve familjare. Përnjëherë, *gastarbajterët* filluan të kthehen në Kosovë, duke bërë që procesi i migrimit të kthehet mbrapsht. Burimi i mbijetesës ekonomike që mbante gjallë viset rurale të Kosovës tani ishte shterur.

Për të kuptuar ndikimin e migrimit në shoqërinë e Kosovës, është me rëndësi të dihet sa shqiptarë nga Kosova jetojnë jashtë Kosovës. Ky numër vështirë mund të përcaktohet me siguri. Në statistikat administrative kosovarët nuk dallohen nga shtetasit e Serbisë dhe Malit të Zi.⁹ Në mars të vitit 1992, “qeveria në ekzil” e Kosovës bëri përpjekjen e parë për të parashikuar numrin e gjithmbarshëm të shqiptarëve të Kosovës që jetojnë jashtë vendlindjes, duke arritur në shifrën prej 217,000 sish. Studimet dëshmuar se komunitetet më të mëdha të shqiptarëve të Kosovës jetojnë në Gjermani (82,348), Zvicër (72,448), Suedi (15,652) dhe Austri (12,300).¹⁰ Gjermania dhe Zvicra vazhduan të mbesin dy destinacionet më të dashura

⁸ Janet Reineck, *The Past as Refuge: Gender, Migration and Ideology Among the Kosovo Albanians*, 1991, f. 10.

⁹ Cay Lienau, “Die Albanische Minderheit”, në veprën: Cornelia Schmalz-Jacobsen dhe Georg Hansen, *Ethnische Minderheiten in der Bundesrepublik Deutschland. Ein Lexikon*, Muni, 1995, f. 52-61.

¹⁰ Kroaci: 9,087; Itali: 5,472; Slloveni: 4,977; Belgjikë: 4,137; Norvegji: 3,522; Danimarkë: 3,314; Francë: 1,998; Holandë: 1,078; Mbretëri e Bashkuar: 338; Finlandë: 295; Luksemburg: 166. Rifat Blaku, *Hintergründe der Auswanderung von Albanern aus Kosova in die Westeuropäischen Staaten*, Vjenë, 1995, f. 10. Ndryshe nga të dhënat e regjistrimit jugosllav, këto shifra përfshijnë punëtorët ilegalë dhe të paregjistruar, si dhe generatën e dytë të shqiptarëve të Kosovës.

për kosovarët edhe gjatë viteve të 90ta. Si rezultat i kësaj, politikat e imigracionit në këto dy vende kanë ndikim substancial edhe në zhvillimet në Kosovë.

Shqiptarët e Kosovës që arritën në Gjermani gjatë viteve të 90ta shpesh kërkonin azil politik por ishin fare pak të suksesshëm. Shumica dërmuese e tyre, përfshirë ata të cilëve u ishin refuzuar kërkesat për azil, përfitonin statusin e “lejeve të tolerimit” (*Duldung*). Kjo atyre u lejonte qëndrim në Gjermani edhe pa definim të statusit formal të tyre, me kushtin se do të ktheheshin në vendlindje menjëherë pasi që situata ta lejonte një gjë të tillë. Pas tërheqjes së forcave serbe nga Kosova, autoritetet gjermane vlerësuan se kishte ardhur momenti për kthimin e tyre.

Në vitin 1999, ato deklaruan se 180,000 kosovarë kishin humbur statusin e tyre juridik dhe duhet të largoheshin nga vendi.¹¹ Gjashtë vite më vonë, 90,000 prej tyre ishin kthyer në Kosovë përmes kthimeve vullnetare me asistencë. 20,000 të tjerë ishin deportuar, ndërsa numri i atyre që janë kthyer pa asistencë nga autoritetet nuk është bërë i njohur.¹² Kjo do të thotë se një pjesë e madhe e shqiptarëve të Kosovës që kishin hyrë në Gjermani gjatë viteve të 90ta u kthyen në Kosovë. Tani shqiptarëve të Kosovës që duan të jetojnë në Gjermani u mbetet vetëm një opsion: bashkimi familjar, i cili aplikohet për fëmijët dhe bashkëshortët e atyre që kanë leje qëndrimi, hapësirë të mjaftueshme për jetesë dhe të hyra stabile. Në vitin 2004 ishin regjistruar saktësisht 4,905 raste të tilla.¹³

Kjo valë masive e largimit nga Gjermania pas luftës konfirmohet me të gjitha të dhënat në dispozicion. Numri i gjithmbarshëm i shtetasve të Serbisë dhe Malit të Zi në Gjermani ra për 212,000 nga viti 1998 në vitin 2004.¹⁴ Nëse këtij numri ia zbresim numrin e personave që kanë fituar shtetësinë gjermane ndërkohë, i bie që 174,000 sish janë larguar nga vendi.¹⁵ Gjatë të njëjtës periudhë, numri i jugosllavëve të punësuar në Gjermani gjithashtu ra për 58,000.

Nga Zvicra nuk pat largim të tillë masiv, edhe pse numri i Kosovarëve atje ishte rritur mjaft shumë gjatë viteve të 90ta. Zyra Qendrore e Statistikave e Zvicrës raportoi në vitin 1999 se në vend ishin 145,000 shqiptarë të Kosovës me status juridik të zgjidhur dhe 50,000 azilkërkues.¹⁶ Megjithatë, rregullat e imigracionit në Zvicër ishin relativisht liberale. Azilkërkuesit të cilët kishin qëndruar në vend për një periudhë të caktuar dhe ishin ekonomikisht aktiv mund të merrnin lejeqëndrimet e përkohshme, apo *permis de séjour*. Ky status u sillte atyre me kalimin e kohës edhe lejeqëndrimet e përhershme. Si rezultat, rrjedhat e migrimit nga Serbia dhe Mali i Zi në drejtim të Zvicrës mbeten pozitive edhe mes viteve

¹¹ Ministria Federale e Punëve të Brendshme, Sachverständigenrat für Zuwanderung und Integration, Bundesamt für Migration und Flüchtlinge, Migrationsbericht. Bericht des Sachverständigenrates für Zuwanderung und Integration im Auftrag der Bundesregierung, in Zusammenarbeit mit dem Europäischen Forum für Migrationsstudien (efms) an der Universität Bamberg – aktualisierte Ausgabe November 2004, f. 41.

¹² Referat i BMI A4, 14 qershor 2005, Rückkehr in das Kosovo seit Juni 1999.

¹³ Bundesamt für die Anerkennung ausländischer Flüchtlinge, Referat 213 – Analyse Mittel-, Ost- und Südosteuropa, Informationszentrum Asyl und Migration, Serbien und Montenegro – Online-Loseblattwerk 15, Flucht und Migration, nëntor 2003.

¹⁴ Beauftragte der Bundesregierung für Migration, und Flüchtlinge, Daten-Fakten-Trends. Strukturdaten der ausländischen Bevölkerung 2004, burimi origjinal: Statistisches Bundesamt/Bundesverwaltungsamt – AZR.

¹⁵ Deri në 2002: Zyra Federale e Statistikave, “Statistika të natyralizimit”, në: Statistisches Bundesamt, Strukturdaten und Integrationsindikatoren über die ausländische Bevölkerung in Deutschland: Lagebericht 2005, f. 22. Zyra Federale e Statistikave.

¹⁶ Marcel Heiniger (Bundesamt für Statistik), “Daten zu Muslimen und Musliminnen in der Schweiz”, në: Tangram, 7/1999, f. 80. 39,000 kanë marrë shtetësinë gjermane gjatë këtyre viteve.

2000 dhe 2004, edhe pse në numra shumë më të vegjël se sa gjatë viteve të 90ta.¹⁷ Bashkimet familjare përbëjnë 68% të të gjitha arritjeve të reja gjatë periudhës në fjalë.

Në periudha të mëhershme, Evropa perëndimore ua kishte hapur dyert punëtorëve migrues nga Kosova dhe ish-Jugosllavia, me qëllim të përmbyshjes së kërkesës së vet për fuqi punëtore të pakualifikuar dhe për punë fizike. Gjatë trazirave të viteve të 90ta, ajo toleroi hyrjen dhe qëndrimin e kosovarëve, në numra të konsiderueshëm, në pritje të stabilizimit të rajonit. Por, nga viti 1999, migrimi ka vazhduar vetëm në numra të vegjël dhe vetëm përmes programeve të bashkimit familjar.

Kjo përbën ndryshim të madh edhe në kuptim të vëllimit edhe në kuptim të karakterit të migrimit nga Kosova. Gjeneratat e kaluara të emigrantëve ishin kryesisht burra të rinj e të pamartuar, të cilët ishin dërguar jashtë vendit nga familjet e tyre me qëllim të gjetjes së punës. Obligimet e tyre sociale ndaj familjeve në fshatrat e tyre ishin të konsiderueshme. Ata do të jetonin në kushte modeste në mërgim, duke e dërguar një pjesë të konsiderueshme të të hyrave të tyre tek kryefamiljarët në vendlindje. Kjo zakonisht do të vazhdonte deri sa të ktheheshin në Kosovë, përveç nëse martoheshin dhe e merrnin nusen me vete në Evropën perëndimore. Në rastet kur ndodhte kjo e fundit dhe ata krijonin familje në mërgim, duke u ndarë kësajsoj edhe formalisht nga ekonomia familjare e tyre në Kosovë, niveli i remitancave binte dukshëm. Me fjalë tjera, remitancat do të binin me kalimin e kohës nëse nuk do të vazhdonte largimi i të rinjve nga Kosova drejt përndimit në kërkim të punës.

Janë tri arsye pse zvogëlohen remitancat. Së pari, numri i gjithmbarshëm i kosovarëve që jetojnë në diasporë ka rënë. Së dyti, diaspora më nuk është duke u ripërtërirë me prurje të reja të meshkujve të pamartuar e të rinj. Së treti, shqiptarët e Kosovës që kanë mbetur në mërgim jetojnë kryesisht me familjet e tyre, e rrjedhimisht kanë më pak mundësi të dërgojnë para në Kosovë.

Fundi i epokës së migrimit masiv ishte natyrisht reflektim i një zhvillimi pozitiv - fundit të represionit politik në Kosovë. Megjithatë, ai nuk ka rezultuar me kurrfarë ndryshimi në situatën ekonomike në Kosovë, e cila kishte bërë që migrimi masiv të jetë burim jetese për viset rurale. Fundi i kësaj epoke i dha fund edhe sigurisë ekonomike të familjeve që gëzonin frytet e këtij migrimi.

C. Ekonomia morale e të dërguarit të parave¹⁸

Duke qenë se njihet si fenomen kyç për ekonominë e Kosovës, mund të thuhet se remitancat nuk janë analizuar me seriozitetin e duhur. Ekonomia morale e të dërguarit të remitancave (kush është i obliguar të dërgojë remitanca dhe kujt duhet t'i dërgohen ato) rrallë herë është analizuar deri tani.

Në vitet e fundit, interesi i ekonomistëve dhe politikëbërësve për remitancat është ngritur anembanë botës. Megjithatë, remitancat duket se janë temë e vështirë për tu trajtuar. Së pari, ato janë tejet vështirë të maten. Shtetet e zhvilluara nuk kanë shifra të sakta mbi mjetet që

¹⁷ Nga viti 2000 deri 2004, rreth 33,900 qytetarë nga Serbia dhe Mali i Zi morrën shtetësi Zvicërrane dhe 8,800 hoqën dorë nga ajo. Numri total u rrit nga 197,000 në 199,200, përkundër naturalizimit të pothuajse 27,000 personave gjatë kësaj periudhe. Ausländer und Asylstatistik, f. 114f dhe 130f.

¹⁸ Për një narrativë të detajuar të stories së diasporës kosovare, shih Paul Hockenos, Homeland Calling – Exile Patriotism and the Balkan Wars, 2003. Për më informata të mëtejme mbi Fondin për Republikën e Kosovës shih, f. 178.

largohen nga vendet e tyre në formë të remitancave, duke qenë se një pjesë e mirë e tyre bartet përmes kanaleve joformale. Së dyti, ekzistojnë disa probleme dhe mosmarrëveshje në kuptim të përkufizimit të tyre. Konceptet që ndërlidhen me remitancat mbulojnë një spektër të gjerë fenomenesh.¹⁹

Definicioni tradicional përmban tri elemente: *remitancat e punonjësve* transferohen nga emigrantët të cilët jetojnë dhe punojnë jashtë vendit. “Emigrant” është ai i cili qëndron (apo pritët të qëndrojë) në një shtet të caktuar një apo më shumë vite, me kusht që i njëjti të mos jetë natyralizuar. *Kompensimet e punonjësve* përbëhen nga pagat dhe beneficionet e fituara nga individë në ekonomi ku ata nuk janë banorë. Kjo përfshinë edhe pagat e fituara nga punëtorët sezonalë jashtë vendit. Në rastin e Kosovës, kjo kategori do të përfshinte edhe pagat dhe beneficionet tjera të cilat Qeveria e Serbisë ua jep serbëve të Kosovës. *Transferet e emigrantëve* janë paratë e gatshme dhe pasuria e sjellë prapa nga emigrantët të cilët kthehen nga shtetet e jashtme. Ndryshe nga dy kategoritë e para, këto janë transaksione të cilat ndodhin vetëm një herë dhe në shumicën e rasteve janë të vogla në krahasim me dy kategoritë e para.²⁰

FMN u përpoq që ta bëjë parashikimin e parë të shumës së gjithmbarshme të remitancave në Kosovë në vitin 2001, duke dhënë shifrën prej 610 milionë euro.²¹ FMN pranonte se një pjesë e madhe e këtij parashikimi ishte bazuar në supozime. Në vitin 2003, Ministria e Financave e Kosovës parashikoi se remitancat dhe të ardhurat nga personat me shtetësi të huaj arrinin shifrën prej €720 milionë.²² Në Raportin Vjetor të vitit 2003, Autoriteti Qendror i Bankave dhe Pagesave (AQBK) i Kosovës, që atëbotë kryente funksionin e bankës qendrore, vlerësoi se remitancat vjetore shënonin €568 milionë.²³ Në Memorandumin Ekonomik të vitit 2004, Banka Botërore sugjeronte se remitancat vjetore mesatarë mes vitit 1999 dhe 2003 kanë qenë €550 milionë.²⁴

Nga viti 2004 fillojnë të shfaqen shifra më të ulëta. Në vitin 2006, FMN i kishte rivizituar supozimet për remitancat e vitit 2001 dhe jepte shifër përgjysmë më të vogël (€317 milionë), por shtonte se kishte pasur një ngritje të vazhdueshme deri në vitin 2005 (€375 milionë).²⁵ Në fakt, në disa raste dukej sikur FMN po i bënte parashikimet mbi remitancat për të plotësuar boshllëqet që i shfaqeshin në të dhënat ekonomike për vendin. Kjo praktikë kritikohet në një dokument të brendshëm të Bankës Botërore – “nuk rekomandohet që t'i kthehet metodës paraprake të FMN të ngritjes së shifrave të remitancave të punëtorëve jashtë vendit vetëm për të zvogëluar gabimet apo lëshimet në kalkulime” – në të cilin kërkohej shfrytëzimi i të dhënave më solide gjatë përgatitjes së parashikimeve.

¹⁹ Grupet e ekspertëve nga FMN dhe Banka Botërore tek para disa vitesh e kanë dhënë një përkufizim të ri që duhet të përdoret nga bankat qendrore anembanë botës. Pasi që shumica e supozimeve të cituara këtu janë bërë para vitit 2005, është përdorur përkufizimi i vjetër. Në përkufizimin e ri, transferet e emigrantëve nuk konsiderohen më remitanca.

²⁰ Departamenti i Statistikave i FMN, Doracaku i Balancit të Pagesave (BPM5).

²¹ FMN, Kosovë – Çështje makroekonomike dhe stabiliteti fiskal, 2001, f. 23.

²² Qeveria e Kosovës në buxhetin e vet të vitit 2003 i referohet “720 milionë remitanca të parave të gatshme, të cilat përfshijnë transferet sociale nga jashtë vendit (në veçanti pensionet dhe përfitimet tjera sociale të paguara tek ish-punonjësit nga qeveritë e Serbisë, Gjermanisë, Zvicrës dhe shteteve tjera), të hyrat nga puna për shqiptarët e Kosovës që aktualisht jashtë vendit (përfshirë Serbinë), dhuratat në para të gatshme të ofruara nga shtetasit e huaj për familjet e Kosovës dhe paratë e gatshme të sjella në Kosovë nga të riatdhesuarit dhe vizitorët. Buxheti i Kosovës për vitin 2003, MEF, f. 8.

²³ Raporti vjetor i AQBK 2003, mars 2004, f. 14 (shifrat e bazuara në FMN). Pensionet e jashtme nuk duket se përbëjnë kategori të veçantë në këtë raport, gjë që sugjeron se ato janë përfshirë si “remitanca”.

²⁴ Banka Botërore, Memorandumi Ekonomik i Kosovës, , Uashington, 17 maj 2004, Raporti Nr.: 28023-KOS.

²⁵ Aide Memoire i FMN 2006.

Ekzistojnë dëshmi të fuqishme që sugjerojnë se remitancat kanë rënë në mënyrë graduale gjatë viteve të fundit dhe se ato janë edhe më të ulëta se sa këto supozime që shfrytëzohen nga autoritete të ndryshme. Sipas dy anketave të fundit të buxheteve të ekonomive familjare, remitancat në ekonomitë familjare rurale kanë rënë nga €58.83 në vitet 2002/03 në €41.65 në vitet 2003/04 – rënie kjo prej 25% brenda një viti të vetëm.²⁶ Gjatë të njëjtës periudhë, të ardhurat mesatare të ekonomive familjare kanë rënë substancialisht, nga €324 në €253, si rezultat i rënies së pagave neto dhe remitancave.²⁷

Ekipi që punoi në anketën e vitit 2003/04 anketoj gjithsej 193,251 ekonomi familjare rurale dhe 88,448 urbane.²⁸ Sipas të dhënave të anketës, remitancat arrijnë gjithsej shumë prej €166 milionë në vitin 2003 dhe €123 milionë në vitin 2004. Kjo është rreth 36% e parashikimit të fundit të FMN-së. Kjo është në konsistencë me gjetjet e Vlerësimit të Varfërisë në Kosovë, që thotë se jo më shumë se 15% të ekonomive familjare të Kosovës marrin remitanca rregullisht në formë të parave të gatshme.

A mund të kenë rënë kaq shpejt remitancat gjatë kësaj periudhe të pasluftës? Një shpjegim mund të gjendet në eksodin masiv të shqiptarëve të Kosovës nga Gjermania. Duke qenë se mbi 100,000 kosovarë u kthyen nga Gjermania ata sollën me vete edhe kursimet dhe pronat e tyre (veturat, pajisjet shtëpiake etj.) Këto përbënin “transfere të emigrantëve” - elementin e tretë nga definicioni tradicional i remitancave. Ato nuk përbënin, sipas fjalorit ekonomik, “rrjedhë të të hyrave” çfarë përbëjnë remitancat e rregullta, por vetëm transaksione që ndodhin një herë. Duket se me gjasë një pjesë e madhe e remitancave në periudhën e pasluftës kanë qenë të kësaj natyre dhe janë ndalur me përfundimin e periudhës së kthimit masiv. Remitancat nuk janë më burim i financimit të vendit, siç kanë qenë deri vonë.

D. Si i mbajti migrimi gratë në shtëpi

Për shumë shqiptarë të Kosovës, migrimi përbënte lidhjen e tyre me botën e jashtme - qoftë nëse atë e kishin provuar drejtpërdrejt atë si emigrantë, apo përmes mallrave të blera nga paratë e fituara jashtë vendit. Supozohet pra që migrimi ka qenë agjent i modernizimit të Kosovës. Por duket të ketë patur ndikim të kundërt në Kosovën rurale gjatë dy dekadave të fundit.

Antropologia amerikane Janet Reineck studioi “çështjet gjinore, migrimin dhe ideologjinë” e rajonit të Opojës në pjesën jugperëndimore të Kosovës nga maji i vitit 1987 deri në dhjetor të vitit 1988.²⁹ Tregimet e saj lidhur me shoqërinë rurale në vitet e fundit para shkatërrimit të socializmit jugosllav vënë në spikamë “trendin e rritjes së konservatizmit në Kosovën rurale që nga viti 1981, si dhe strategjitë e përdorura për ta forcuar atë edhe më tej: martesat e aranzhuara, kufizimi i lëvizjes së grave jashtë shtëpisë dhe mosdërgimi i vajzave në shkollë të mesme.”

²⁶ Zyra Statistikore e Kosovës (ZSK) ka kryer dy anketa të buxheteve të ekonomive familjare, njëra e publikuar në vitin 2003 dhe tjetra në vitin 2005. Këto anketa kanë analizuar ndaras ekonomitë familjare urbane dhe rurale, duke vëzhguar për çdo muaj 200 ekonomi familjare për 24 muaj me radhë. Gjatë çdo ankete janë shtruar pyetje të ndryshme të drejtpërdrejta për 2,400 familje, lidhur me konsumin, shpenzimin dhe burimet e të ardhurave. ZSK, Statistikat e Standardit të Jetesës 2002-2004, Prishtinë, maj 2005, f. 3.

²⁷ Po aty, f. 4.

²⁸ Komunikimi me këshilltarin ndërkombëtar të Zyrës së Statistikave të Kosovës, Sasun Tsirunyan, 9 shkurt 2006 dhe 21 shkurt 2006.

²⁹ Rajoni i Opojës atëherë kishte 37,400 banorë dhe përbëhej nga 21 fshatra. Në fakt, Reineck jetoi në Kosovë mbi katër vite e gjysmë mes viteve 1981 dhe 1989.

Reineck vërente se për një rajon si Opoja migrimi kryente një funksion esencial social: në mendjet e popullsisë, migrimi ofron të vetmen shpresë për t'i ikur varfërisë. Kjo zonë ka prodhuar punëtorë migrues për shekuj me radhë. Megjithatë, migrimi nuk ishte i mirëpritur. Ajo citon një fshatar:

“Nënkuptohet se ne do të bëhemi punëtorë migrues. Migrimi është barrë në krahët e secilit prej nesh. Neve nuk na pëlqen kjo ide, por ajo përbën realitet për shumë familje. Migrimi është traditë e krijuar nga të parët tanë. Gjithnjë ka qenë kësisoj.”³⁰

Në tregimet, këngët dhe poezitë popullore migrimi është ekuivalent i vuajtjes. “Të ndarë dhe në azil, për vetëm një dinar”, “Ai që nuk ka njohur vuajtjen e migrimit nuk e di çka është jeta”, “Kush i pari bani gurbetin, atij zoti kurrë mos ia dhashtë selametin” janë disa prej thënieve të tilla! Apo, siç thuhet në një poezi:

*Baba, mik n' shpi t' vetë
O kofsh mallkue i Zi gyrbet!
Sa na lindin fmi e fmi,
Nuk kanë babë o me thirr n' shpi.*³¹

Reineck vërente një dallim të theksuar sa i përket ndikimit që kishte migrimi brenda vendit dhe migrimi në shtete të jashtme. Në Opojë, burrat që gjenin vende pune në qytetet e afërta vazhdonin të qëndronin afër shtëpive të tyre, vinin për vizita të shpeshta dhe ishin më të hapur ndaj vlerave të reja se sa ata që iknin jashtë vendit.

“Burri që ekspozohet ndaj ideve jo-opojane, por të cili ishte mjaft afër për të vëzhguar sjelljet e familjes së tij, ishte më elastik në interpretimin e kulturës lokale. Ai mund të dërgojë vajzat e tij në shkollë sepse është mjaft afër për ta përcjellë sjelljen e tyre. Gruaja e tij mund t'i vizitojë të afërmit në Prizren sepse ai është diku në afërsi dhe komuniteti i tij e di këtë.”³²

Në anën tjetër, ata që jetonin më larg dhe vizitonin familjen më rrallë, insistonin që familja të jetonte strikt sipas vlerave morale konservative për të “mbrojtur” gratë dhe fëmijët e tyre.

“Burrat besojnë se prindërit dhe anëtarët tjerë të familjes do të jenë më të sigurt nëse gjatë mungesës së tyre të gjithë sillen në mënyrë më strikte dhe tradicionale. Ata gjejnë rehatinë kur janë jashtë vendit duke e ditur se kurdo që të kthehen në vendlindje do ta gjejnë të njëjtën mënyrë të jetesës që e kanë lënë atje muaj, vite a dekada më parë. Të vetmet ndryshime që shpresojnë t'i shohin janë ndryshimet në gjendjen financiare të familjes.”³³

Në qendër të kësaj mënyre jetese gjendej familja e madhe patriarkale. Mesatarisht, ekonomitë familjare të Opojës në vitin 1989 kishin 10 anëtarë. Brenda secilës familje, “gratë u binden burrave, të gjithë meshkujve të rritur të familjes dhe disa grave më të vjetra në moshë. Burrat u binden të vjetërve. Të gjithë i binden kryefamiljarit.”³⁴

Ata me qëndrim jashtë vendit ishin në gjendje të mbajnë materialisht familjet e tyre, tu sigurojnë shtëpi të reja dhe pajisje moderne. Megjithatë, sigurimi i të mirave materiale nuk

³⁰ Janet Reineck, *The Past as Refuge*, 1991, f. 125.

³¹ Xhemali Berisha, *Remember This, Migrant Men*, 1988, cituar nga Reineck, f. 163.

³² Janet Reineck, *The Past as Refuge*, 1991, f. 161.

³³ Po aty, f. 190.

³⁴ Po aty, f. 76.

ndryshoi aspak vlerat dhe qëndrimet tradicionale. Reineck citon një fshatar nga Opoja të ketë thënë:

“Këta të pashkollët që emigruan dhe u pasuruan dhe shpërndanë mënyrën e tyre të jetesës në Opojë janë përgjegjës për prapambeturinë tonë. Ideja e tyre e zhvillimit është që të organizojnë dasma të mëdha, të veshin gratë me rroba të shtrenjta, të ndërtojnë shtëpi të reja dhe të blejnë vetura të reja. Ata janë njerëzit më konservativ dhe me më së shumti ndikim. Përderisa unë t'i kem xhepat bosh, unë nuk mund të kem ndikimin që ata kanë.”

Varësia financiare nga baballarët që ishin larg shtëpisë forcoi edhe më shumë pasivitetin dhe fatalizmin e atyre që kishin mbetur në shtëpi, perspektiva e të cilëve për të gjetur punë në Kosovë ishte e dobët.

“Duke e parë se planifikimi i të ardhmeve të tyre ishte pothuajse i kotë, djemtë prisnin ditëlindjet e tyre të tetëmbëdhjeta, njëzeta e njëzetepesta me shpresë të zbehtë se do të marrin ftesë për punë nga të afërmit e tyre jashtë vendit, gjë që do t'i shpëtonte ata nga e ardhmja e pasigurt që i priste në shtëpi.”³⁵

Reineck theksonte se situata që ajo e përshkruante në Opojë ishte e ngjashme edhe në tërë Kosovën rurale gjatë viteve të 80ta. Atëbotë, nga 45,000 nxënës që regjistroheshin në shkollë fillore çdo vit, më pak se 8,000 e kryenin klasën e tetë.³⁶ Në vitin 1988, më shumë se 90% të grave shqiptare në Kosovë ishin “ekonomikisht të varura”. Vërehej një diskrepancë e fortë mes situatës në Prishtinë (ku në vitin 1988, 41% e vajzave vijonin shkollimin e mesëm) dhe zonave rurale (ku kjo shifër ishte shpesh nën 4%).³⁷

A është ende e arsyeshme që të supozohet se zonat rurale që kanë më shumë migrim jashtë vendit vazhdojnë të jenë më konservative? Cili do të jetë ndikimi i përfundimit të migrimit masiv për këto fshatra?

III. PËRSE KA NGECUR KOSOVA

Në fshatrat e Kosovës aktualisht po zhvillohet një dramë e vërtetë.³⁸

Gjatë viteve 2004 dhe 2005, dy fshatra ndihmuan ESI në kryerjen e një ankete të plotë të kushteve të jetesës në vendet rurale. Gjithsej 527 ekonomive familjare iu parashtruan nga 44 pyetje. Qëllimi ishte që të fitohej një pasqyrë e qartë e Kosovës rurale në vigjilje të vendimit për statusin final të Kosovës.³⁹

Cërrca është fshat me 300 shtëpi në veriperëndim të Kosovës pranë kufirit me Shqipërinë. Lubishta është fshat me 227 shtëpi që gjendet rrëzë maleve të Karadakut në juglindje të Kosovës, afër kufirit me Maqedoninë. Sipas standardeve të Kosovës, Cërrca është fshat mjaft i pasur; Lubishta është fshat i varfër. Megjithatë, në të dy fshatrat janë duke vepruar të njejtat trende ekonomike e sociale që po e riformësojnë Kosovën rurale.

³⁵ Po aty, f. 191.

³⁶ Po aty, f. 168.

³⁷ Po aty, f. 178.

³⁸ Gjatë viteve 2004 dhe 2005, hulumtuesit e ESI kanë vizituar një numër të madh të fshatrave të Kosovës, duke intervistuar shumë persona në lidhje me ndryshimin e kushteve të jetesës në komunat e Vitisë, Gjilanit, Rahovecit, Mitrovicës, Prizrenit, Prishtinës dhe Shtërpçës.

³⁹ Për më shumë informata mbi pyetësorin dhe hulumtimin, shihni Shtojcën 4. Të gjitha të dhënat janë përmbledhur në Shtojcat I dhe II.

A. Një fshat i varfër dhe familjet më të mëdha në Evropë

Në vitin 2005 rruga e asfaltuar që shpie në fshatin Lubishtë dërgonte vetëm deri tek qendra e vogël e fshatit. Përderisa disa prej shtëpive ishin të mëdha dhe të reja, disa tjera ishin duke u shkatërruar fare. Mbi kodrat e fshatit është ngritur xhamia e re e ndërtuar kryesisht falë remitançave të grumbulluara nga diaspora e fshatit në Gjenevë. Pranë xhamisë gjenden kontejnerët që janë donacion nga ushtria e SHBA-ve e të cilat tani përdoren si klasa të shkollës. Ishte bërë një përpjekje që të ndërtohet një godinë e re shkollore, duke qenë se shkolla e ndërtuar në fillim të viteve të 70ta ishte dëmtuar nga një tërmet i vitit 2002, por ky projekt dështoi për shkak të mungesës së fondeve, duke lënë godinën e shkollës të pakryer. Ajo që vërehet menjëherë është mungesa e çfarëdo forme të jetës shoqërore, përveç shitores së vogël në sheshin e fshatit. Një internet café ishte hapur dhe mbyllur pak më vonë. Fëmijët grumbullohen në momentin që ndonjë vizitues ndalet kudo në fshat për më gjatë se 1 minutë. 45% të popullsisë së fshatit janë nën moshën 16-vjeçare.

Historia e Lubishtës është pasqyrim i ngecjes së Kosovës. Cilësia e tokës është e dobët, dhe atje nuk ka ujë të mjaftueshëm për të zhvilluar bujqësinë. Deri në mes të viteve të 70ta nuk kishte ekzistuar rruga për të lidhur fshatin me pjesën tjetër e luginës dhe qendrën e komunës së Vitisë, në lindje të Kosovës.

Lubishta dikur ishte komunitet blegtoral. Barinjët i dërgonin tufat e tyre në kullosa verore në malet e Karadakut, por vendosja e kufirit ndërkombëtar me Maqedoninë në vitet e 90ta shënoi fundin e kësaj praktike. Gjatë dekadës së fundit, ky rajon malor ka shërbyer si vendstrehim për rebelët shqiptarë nga Maqedonia dhe Lugina e Preshevës. Pas konfliktit në Maqedoni në vitin 2001, disa qindra shqiptarë të Maqedonisë gjetën strehim të përkohshëm në Lubishtë. Në vitin 2005, popullsia shënonte 2,134 banorë, nga të cilët 572 ishin jashtë vendit, kryesisht në Zvicër dhe në komunitete të ngushta në Bazël e Gjenevë.

Kosova ka familjet më të mëdha në Evropë. Ajo gjithashtu ka ruajtur një formë të strukturës patriarkale të familjes që dikur ishte e përhapur në tërë Ballkanin, një strukturë të familjes që ka mbijetuar 50 vite komunizëm, dekada të tëra të migrimit masiv në shtetet e perëndimit dhe zhdukjen e ekonomisë blegtorale.⁴⁰

Është mbresëlënës fakti se madhësia e familjes në Kosovë nuk ka ndryshuar përgjatë gjysmë shekulli komunizëm nën Jugosllavi. Në vitin 1948, familja mesatare në Kosovë numëronte 6.4 anëtarë. Në vitin 1981, kjo shifër kishte arritur 6.9 anëtarë, ndërsa në vitin 2003 kishte rënë paksa në 6.4 anëtarë.⁴¹ Për ta vënë këtë të dhënë në kontekst, duhet pasur parasysh se madhësia mesatare e ekonomisë familjare në Zonën Ekonomike të Evropës ra nga 2.8 në vitin 1980 në 2.5 në vitin 1995, me Irlandën e cila dallohet si shteti me familjet më të mëdha në Evropën Perëndimore (me mesatare prej 4.0).⁴²

⁴⁰ Ekonomitë e tilla familjare janë përshkruar në vitet e 90ta nga Karl Kaser (Familie und Verwandtschaft auf dem Balkan – Family and Relations in the Balkans, 1995; dhe Hirten, Kaempfer, Stammeshelden – Sheppards, Fighters, Tribal Heroes, 1992); në fundin e viteve të 80ta nga Janet Reineck (The Past as Refuge, 1991); në të 70at nga Berit Backer (Behind Stone Walls – Changing Household Organisation Among the Albanians of Kosova, 1979); dhe në të 90at nga Gjergj Rrapi (libri u publikua në vitin 2003 në gjermanisht nën titullin Die albanische Groszfamilie im Kosovo); si dhe në vitet e 30ta nga Vera Erlich (Family in Transition), mes tjerash.

⁴¹ ZSK, Anketa Demografike dhe Shëndetësore, 2003.

⁴² ZEE në vitin 1995 përbëhej nga 15 shtetet anëtare të BE-së plus Norvegjia, Islanda dhe Lihtenshtajni. Burimi: Agjencia Evropiane e Mjedisit, Faktet mbi Treguesit 2001.

Në vitin 2005, familja mesatare në fshatin Lubishtë numëronte 9.5 anëtarë. Para njëqind vitesh, një familje e tillë do të gjendej anekënd viseve rurale të Ballkanit, dhe shpesh njiheshin me emrin sllav të tyre – *zadruga* (shqip ‘kooperativa’).⁴³ Ky emër i referohet praktikës që burrat të qëndrojnë në shtëpi pas martesës duke krijuar familje të mëdha që përfshijnë disa familje nukleare përnjëherë.

Një nga studiueset më të zellshme të familjeve të tilla ishte Vera Erlich e cila kreu një studim të madh krahasues të familjeve të Jugosllavisë gjatë viteve të 30ta. Ajo studioi 300 fshatra të shqiptarëve, të myslimanëve të Bosnjës, të krishterëve të Bosnjës, të serbëve dhe kroatëve.

“Parimi themelor i *kooperativës* ishte që meshkujt kurrë të mos largohen nga shtëpia e përbashkët. Djemtë dhe trashëgimtarët e tyre do të qëndronin brenda ekonomisë familjare, ndërsa vajzat do të largoheshin pas martesës për tu bërë anëtare të *kooperativave* të familjeve të bashkëshortëve të tyre. *Kooperativa* qeverisej me një sistem hierarkie, ku çdo pjesëtar mbante një rang të caktuar. Rangu përcaktohej nga mosha dhe gjinia, ku kriteri i gjinisë ishte më i fuqishëm se sa kriteri i moshës: të gjithë meshkujt ishin më superior se sa cilado grua...”⁴⁴

Si njësi ekonomike, *kooperativa* është vërtetë kolektiv. Të gjitha pronat janë të përbashkëta.

“Në kooperativë, përveç veshjeve dhe objekteve të vogla, nuk ekziston parimi i pronës private. Paratë administrohen nga zoti i shtëpisë, apo nga mashkulli tjetër të cilit i është deleguar shitblerja si detyrë.”⁴⁵

Të gjitha vendimet kryesore merren nga zoti i shtëpisë: nga koha e mbjelljes së drithërave apo therjes së bagëtisë, e deri te definimi ‘mënyrës së duhur të jetesës’. Ky autoritet vazhdon të ekzistojë edhe sot, duke qenë se janë zotët e shtëpisë ata që vendosin se si do të shpenzohen remitancat e dërguara nga familjarët jashtë vendit, si dhe sa shkollim duhet të vijojnë fëmijët e familjes. Të gjithë burrat e familjes duhet të kontribuojnë përqindje të njëjtë të të ardhurave të tyre në pasurinë e familjes, pa marrë parasysh se çka punojnë për momentin. Të ardhurat grumbullohen në një vend ndërsa anëtarët e familjes kanë të drejta të barabarta për t’i mbuluar nevojat e tyre themelore. Me rastin e ndarjes së ekonomive familjare, tërë pasuria ndahet në mënyrë të barabartë mes vëllezërve, përfshirë tokën. Pasi që bashkëshortet vijnë nga fshatra tjera e vajzat pritët t’u bashkëngjiten kooperativave tjera pas martesës, gratë nuk trashëgojnë pasurinë familjare dhe kanë status të nënshtruar brenda ekonomisë familjare.⁴⁶

Është brengosëse se sa pak ka ndryshuar në organizimin e ekonomive familjare që nga ajo kohë. Në Lubishtë në vitin 2005 ka pasur 89 ekonomi familjare me mbi 10 anëtarë dhe 34 sish me mbi 15 anëtarë.

Ismet Islami (49), drejtor i shkollës fillore në Lubishtë është një nga burrat më të shkolluar në fshatin e tij. Ai është arsimuar në Universitetin e Prishtinës dhe sot ka vështirësi t’ua sigurojë pesë fëmijëve të tij (tre djem e dy vajza) të njëjtën mundësi. Dy veç janë studentë, ndërsa më i riu vijon shkollën e mesme. Përkundër faktit se është i shkolluar, Ismeti vazhdon të jetë tradicional. Ai dhe bashkëshortja jetojnë me prindërit e tij. Babai i tij tani vendosë se si do ta

⁴³ Gjithashtu të njohura si ‘ekonomitë familjare të Ballkanit,’ ‘ekonomitë familjare me shumë familje,’ ‘familjet patriarkale të Ballkanit,’ ‘komplekse’, apo ‘familje me bashkëjetesë’.

⁴⁴ Vera Erlich, *Family in Transition*, 1966, f. 32.

⁴⁵ Po aty, f. 34.

⁴⁶ Rregulli i pashkruar se gratë nuk duhet të trashëgojnë pasuri është në kundërshtim edhe me të drejtën islame edhe me Ligjin për Familjen të Jugosllavisë të vitit 1946. Antropologët i referohen parimit të martesës vetëm me gra që nuk vijnë nga i njëjti fshat si eksogami, ndërsa fakti që gratë vijnë në ekonominë familjare të burrit njihet si patrilokalitet.

shpenzojë ai pagën e tij prej 222 euro në muaj. Ekonomia familjare e tij posedon gjashtë hektarë tokë, ai kultivon 8 kokë bagëti për të mbuluar kostot e studimeve të fëmijëve të tij. Po të kishte vëllezër, shpjegon ai, të ardhurat nga toka do duhej të ndaheshin me ta dhe fëmijët e tyre, e përfundimisht edhe vetë toka do duhej të ndahet mes tyre.

Qefser Qahil jeton në një shtëpi me 5 dhoma bashkë me vëllain e tij në Lubishtë. Vëllai i tij punon si mësues në shkollën fillore të fshatit dhe ka gjashtë djem e një vajzë. Qefseri ka dy djem dhe një vajzë. Tani që dy djem të vëllait të tij filluan studimet, Qefseri duhet të punojë edhe më shumë për të përkrahur financimin e studimeve të tyre. Së fundmi, ai filloi ndërtimin e një shtëpie të dytë, për tu përgatitur për ndarjen e pasurisë. Pasi që të kenë dy shtëpi, ai dhe vëllai i tij do të ndajnë pesë hektarë tokë në dy hise. Nga ai moment e tutje, këto dy familje do të funksionojnë si njësi të ndara ekonomike.

Mbijetesa e familjeve të mëdha edhe për kaq shumë kohë pasi që janë zhdukur nga pjesa tjetër e Ballkanit është një nga tiparet më karakteristike të viseve rurale të Kosovës sot. Në pamje të parë, kjo duket të përbëjë një anakronizëm specifik, duke marrë parasysh ndryshimet marramendëse në ekonomi dhe shoqëri që nga përfundimi i luftës së dytë botërore, e në veçanti shkatërrimin e mënyrë tradicionale blegtorale të të jetuarit, margjinalizimin e bujqësisë dhe zhvillimin e ekonomisë me para të gatshme.

Në Kosovë para gjysmë shekulli tokë kishte mjaft. Por, në ekonomitë familjare bujqësore të asaj kohe kishte mungesë së fuqisë punëtore. Me më shumë burra në një ekonomi familjare kishe më shumë pasuri dhe ndikim, mund të kultivoje më shumë tokë dhe të rrisje më shumë bagëti. Familjet e mëdha ishin të vetëmjaftueshme në shumë aspekte, nga sigurimi i ushqimit dhe veshmbathjeve e deri tek ndërtimi i shtëpive dhe prodhimi i mobileve, ndërsa pjesëmarrja e tyre në transaksione me para të gatshme ishte fare margjinale. Normat e larta të mortalitetit mbanin rritjen e popullsisë në nivel të ulët, dhe nuk lejonin rritjen e familjes në përmasa të pamenaxhueshme.

Megjithatë, nga vitet e 50ta e tutje, me avancimin e shërbimeve shëndetësore në Kosovë erdhi edhe rënia e theksuar e mortalitetit dhe rritja e dukshme e popullsisë. Si rezultat i përmirësimit të shërbimeve shëndetësore jetëgjatësia u ngrit nga 49 vite në vitin 1952 në 68 vite në vitin 1982 për meshkuj, përkatësisht nga 45 në 72 vite për femra! Në fund të viteve të 80ta, rritja e popullsisë shënonte mbi 2.5%, normë kjo më e lartë se viteve të 40ta.⁴⁷ Me normë të tillë të rritjes, popullsia dyfishohet për çdo 30 vite.

B. Fshati i Rugovës dhe mungesa e tokave

Imer Maxharraj, pensionist dhe dikur një nga ekspertët më të shquar në Kosovë për ujitje, lindi në Cërrcë në vitin 1939, në një komunitet që ka ndryshuar fare pak njëqind vitet e fundit. Fshati atëherë kishte vetëm 14 familje të mëdha. Pesë familjet më me ndikim jetonin në kulla, shtëpi të ndërtuara si kështjella me mure të trasha nga gurët dhe me dritare të vogla në katin e dytë. Madhësia e familjes – deri në 40 anëtar – ishte shenjë e pasurisë dhe ndikimit. Këto ekonomi familjare ishin kryesisht të qëndrueshme financiarisht, duke prodhuar jo vetëm ushqimin por edhe rrobat dhe mobiliet e tyre vetë.

Familja Maxharraj kishte dhi, dele dhe lopë, nga të cilat merrte mishin, qumështin dhe djathin. Ajo gjithashtu mbillte misër, grurë, elb, pemë e perime, me të cilat prodhonte bukë e

⁴⁷ Karl Kaser, *Familie und Verwandtschaft auf dem Balkan*, 1995, f. 138.

raki. Babai i Imerit, i zoti i shtëpisë, i ndante detyrat: njëri kujdesej për dhentë, tjetri punonte tokën me plug me qe, i treti siguronte drutë. Lopët qumështore ruheshin nga fëmijët, të cilët kalonin muajt e verës nëpër kullosa malore. Kuajt dhe qetë shfrytëzoheshin për të sjellë drutë nga pylli dhe gurët për ndërtim nga malet. Kohë pas kohe familja fitonte para pasi shiste bagëtitë apo perimet e veta në tregun e Istogut. Megjithatë, familja mbijetonte edhe duke mos qenë pjesë e ekonomisë së parasë së gatshme, kryesisht për faktin që punët kryheshin nga anëtarët e familjes.

Në vitin 2005, në Cërccë gjendeshin 27 familje të mëdha, me disa familje nukleare që jetonin nën të njëjtin kulm. Shumë prej formave tradicionale të familjes patriarkale ende kanë mbijetuar: nuk ka pothuajse asnjë grua të pamartuar mbi moshën 30-vjeçare, meshkujt më të vjetër ende i marrin vendimet në emër të familjes, jeta familjare është e organizuar rreth një hierarkie të pastër.

Haki Haskaj (36-vjeçar) i cili mban kafënë Globi në Cërccë ka punuar për shumë vite në Austri dhe Gjermani, por ende jeton në të njëjtën ekonomi familjare me babanë e tij, i cili po ashtu ka punuar në Gjermani, dhe me vëllain e tij. Dy bashkëshortet e tyre kujdesen për nëntë fëmijë ndërsa të gjitha të ardhurat vazhdojnë të grumbullohen e shfrytëzohen bashkërisht.

Rritja e popullsisë ka shtyrë familjet e mëdha që të ndërtojnë shtëpi të reja dhe të ndahen. Në Cërccë, familja Rugova u nda së pari në vitin 1949, ngjarje e madhe kjo në jetën e fshatit e cila ende kujtohet nga gjenerata e vjetër. Sot, familja Rugova ka 27 shtëpi që gjenden në mëhallën Rugova.⁴⁸ Familja e Maxharrajt së pari u ndanë në vitin 1961, ndërsa tani mëhalla Maxharraj përbëhet nga 16 shtëpi. Rexhajt, që u ndanë të parët në fshat tani kanë 91 shtëpi në disa mëhalla të Rexhajve.

Me çdo ndarje toka ndahej mes djemve, ndërsa sipërfaqja e tokës që e posedonte çdo shtëpi sa shkonte e tkurrej. Sot, sipërfaqja mesatare e tokave në posedim të familjeve në Cërccë është rreth 1 hektar. Është në rritje numri i ekonomive familjare rurale që nuk posedojnë fare tokë bujqësore. Si rezultat i kësaj, ekonomitë familjare rurale nuk janë të qëndrueshme financiarisht dhe janë tërhequr drejt ekonomisë së parasë së gatshme.⁴⁹ Jetesa tipike blegtorale nuk ekziston më ndërsa një pjesë e më e madhe e ushqimeve duhet të blihen. Shkathtësitë tradicionale në ndërtimtari dhe zdrukthëtari tani ofrohen kundrejt një çmimi të caktuar dhe përbëjnë bërthamën e sektorit privat rural.

Por, ka ndryshuar edhe mënyra e jetesës rurale. Analfabetizmi, që ka qenë i përhapur në vitet e 40ta, kishte rënë në 21% në vitin 2000 (megjithëse edhe kjo normë është më e lartë se ajo e vitit 1981).⁵⁰ Mes personave nën moshën 30-vjeçare kjo normë ka rënë nën 2%.⁵¹ Shtëpitë janë të mbushura me mallra të importuara, përfshirë televizione satelitore, të cilat sugjerojnë se ekziston një etje për imazhe nga anembanë bota. Migrimi ka sjellë njohuri mbi vlerat dhe jetesën moderne edhe në pjesët më të izoluara të Kosovës.

Për këto arsye, për dekada të tëra historianët janë duke parashikuar rënien e sistemit të familjeve të mëdha në Kosovë. Viteve të 60ta, Vera Erlich u thoshte lexuesve të saj se u

⁴⁸ Mëhallat janë kyçe për organizimin e jetës shoqërore. Vendimet që prekin fshatin (për shembull ku të vendosen varrezat e reja) merren në këshillin e përfaqësuesve të mëhallës.

⁴⁹ Me rritjen e kërkesës për tokë, familjet ndërtojnë në tokën që është përdorë për të shërbyer si kullosa për tufat e tyre. Por, nëse duhet të blejnë ushqimin për dhentë e tyre atëherë nuk ia vlen të mbajnë dele fare.

⁵⁰ Qendra e Edukimit e Kosovës, Facts and Figures about education in Kosovo, 2001.

⁵¹ Zyra Statistikore e Kosovës, Anketa Demografike dhe Shëndetësore 2003, 2004.

ofronte “imazhin e fundit të një anije në përmblytje; pasqyrën e fundit të një sistemi social patriarkal i cili është para shkatërrimit.” Në vitin 1979, autorja norvegjeze Berit Backer përmblylli studimin e saj të një fshati të Kosovës perëndimore duke thënë:

“Procesi i ndryshimit në Isniq është i pakthyeshem. Mënyrat e reja të sjelljes nuk do lejojnë kthimin e mënyrave të vjetra të jetesës... Sidoqoftë, duket qartë nga idealet aktuale të rinisë së këtij fshati se epokës së kooperativave i ka ardhur fundi.”⁵²

Historiani austriak Karl Kaser shkruante në vitin 1995 se familjet patriarkale të Ballkanit të cilat edhe ashtu tani gjendeshin vetëm në zonat e banuara nga shqiptarët, ishin pjesë e një ‘kulture që po venitej’ dhe do të zhdukeshin nga forcat e zhvillimit socio-ekonomik.⁵³

Tabela: Përbërja e ekonomive familjare – Lubishtë dhe Cërccë

| % | Lubishtë | numri i anëtarëve | Cërccë | % |
|----------------|------------|-------------------|------------|----------------|
| 10.5 % | 24 | 1-4 anëtarë | 65 | 21.7 % |
| 50.7 % | 116 | 5-9 anëtarë | 195 | 65.0 % |
| 23,6 % | 54 | 10-14 anëtarë | 28 | 9.3 % |
| 14.8 % | 34 | 15-30 anëtarë | 12 | 4.0 % |
| 0.4 % | 1 | mbi 30 anëtarë | 0 | 0.0 % |
| 100.0 % | 229 | Gjithsej | 300 | 100.0 % |

Megjithatë, parashikimet për shpërbërjen e familjes patriarkale nuk dolën të vërteta. Edhe pse janë të dukshme shenjat që ajo po rrezikohet të shpërbëhet, në veçanti në kuptim të mungesës së tokës, ndryshimet dramatike në formësimin shoqëror që i pamë në të gjitha pjesët tjera të Ballkanit para shumë brezash në Kosovë ende nuk janë jetësuar. Ky është paradoksi kryesor i Kosovës rurale sot dhe ka dy shpjegime kyçe: historia dhe ndikimi i komunizmit jugosllav në Kosovë dhe ndikimi i migrimit masiv dhe remitançave kohëve të fundit.

C. Si dështoi komunizmi

Agjenda ekonomike dhe shoqërore e komunizmit jugosllav synonte zhvillimin e viseve rurale. Sociologët jugosllavë të epokës para komunizmit kishin studiuar të ashtuquajturat ‘regjione pasive’, të cilat i shihnin si ‘zona të cilat nuk arrijnë të prodhojnë mjaft ushqim dhe të cilat nuk kanë mundësi të mjaftueshme të fitimit të jetesës, mbijetesës e të cilave varet në masë të gjerë nga mjetet nga jashtë.’⁵⁴ Jozo Tomasheviq vërente:

“problemi i mbipopullimit bujqësor është çështje ekonomike kyçe për vendin... pasi që migrimi masiv ishte i pamundur, e vetmja mënyrë për t’iu qasur këtij problemi ishte gjetja e një zgjidhjeje permanente – përmes industrializimit.”⁵⁵

Komunistët jugosllavë ishin të prirë nga vizioni i zëvendësimit të ekonomisë së mbijetesës me një ekonomi moderne, urbane dhe industriale. Fshatarët do të edukoheshin që t’i ikin mentalitetit të mbijetesës dhe të adaptonin një “mentalitet që synon zhvillim industrial dhe i

⁵² Berit Backer, *Behind Stone Walls – Changing Household Organisation Among the Albanians of Kosova*, 1979, f. 106.

⁵³ Karl Kaser, *Familie und Verwandtschaft auf dem Balkan*, 1995.

⁵⁴ Jozo Tomasevic, *Peasants, Politics and Economic Change*, f. 265.

⁵⁵ Po aty, p 338.

cili shton pasurinë shoqërore.”⁵⁶ Mjet i realizimit të këtij transformimi ishte ndërtimi i fabrikave në pronë shoqërore, të shpërndara në mënyrë strategjike në tërë territorin, sipas një logjike sociale dhe politike, e jo sipas kërkesës dhe arsyeshmërisë ekonomike.

Megjithatë, që nga fillimi, komunizmi jugosllav në Kosovë ofronte një përvojë krejt tjetër. Së pari, për pjesën më të madhe të kohës ai ishte shumë më represiv se sa në pjesët tjera të vendit. Kosova ka vuajtur disa periudha në të cilat represioni ka qenë i motivuar etnikisht: nga viti 1945 deri në vitin 1966 (e ashtuquajtura periudha e Rankoviqit, e emëruar sipas shefit famëkeq të policisë sekrete të Titos) dhe prapë gjatë viteve 1989 deri 1999 gjatë epokës së Millosheviqit. Periudha menjëherë pas luftës karakterizohej nga ekzekutimet dhe konfiskimet e pronave të cilat nën udhëheqjen e Rankoviqit u shndërruan në një valë brutaliteti që në vitin 1956 shtyu shumë kosovarë që të regjistrohen si ‘turq’ dhe të emigrojnë në Turqi. Të 70tat ishin relativisht të qeta por trazirat u shfaqën sërish në vitin 1981. Kriza ekonomike dhe sociale në Serbi dhe Kosovë kulmoi kur Millosheviqi suprimoi autonominë e Kosovës dhe largoi masivisht shqiptarët nga puna në sektorin publik. Sipas kësaj që u tha, për 54 vite komunizmi 31 vite u përshkuan nga represioni i rëndë.

Së dyti, zhvillimi komunist në Kosovë ishte i vonuar dhe tejet sipërfaqësor. Në vend nuk kishte program serioz të industrializimit deri në mesin e viteve të 60ta. Në Prishtinë dhe Mitrovicë u ndërtuan një numër i vogël i fabrikave krahas një administrate shumë të gjerë publike, të cilat jepnin një përshtypje të modernizimit të zbehtë. Por, zhvillimi komunist as që filloi të prekte Kosovën rurale.

Komuna rurale e Vitisë, pjesë e së cilës është fshati Lubishtë, e ilustron më së miri këtë fakt. Deri në mesin e viteve të 70ta nuk kishte zhvillim industrial të asnjë lloji. Më pas në vitin 1976 u hap një gurore e në vitin 1979 një fabrikë e përpunimit të drurit. Në vitin 1980 u krijua edhe kompania për përpunimin e metaleve Vinex, në të cilën prodhoheshin vida e burma.⁵⁷ Më vonë u hapën edhe një mulli i miellit dhe një fabrikë e ujit mineral.

Në vitin 1985, u themelua edhe punëdhënësi më i madh në këtë komunë – fabrika e tekstilit Letnica e cila prodhonte uniforma pune. Ky ishte investim politik me qëllim të krijimit të vendeve të punës për rreth 460 kroatë katolikë të këtij rajoni. 50% të fondeve vinin nga Kroacia. Pas vitit 1991, kur kroatët u larguan nga ky rajon, fabrika ndërpreu prodhimin. Në pikën më të lartë të prodhimtarisë, në fund të viteve të 80ta, në këtë komunë me rreth 50,000 banorë, në industrinë e sektorit shoqëror punonin jo më shumë se 1,500 persona. Shumë prej tyre ishin serbë dhe kroatë.

Mungesa e çfarëdo dinamike të vërtetë ekonomike në qytete gjithashtu kishte pasoja për viset rurale, në veçanti për fshatrat shqiptare. Në vitet e 50ta, qendra e komunës në Viti kishte 700 banorë. Pothuajse asnjë prej tyre nuk ishte shqiptar. Në vitin 1978 kur Isa Uka, zyrtari më i lartë komunist nga Lubishta bleu një shtëpi në këtë qytet, ai bë shqiptari i shtatë që posedonte shtëpi aty.

Fshati Lubishtë mbeti jashtë çfarëdo përpjekjeje, qoftë edhe më sipërfaqësore, për të siguruar zhvillim. Deri në vitin 1970 në këtë fshat nuk kishte depërtuar as rrjeti elektrik. Rruga deri në fshat u ndërtua në vitin 1976. Deri atëherë banorët e fshatit detyroheshin që në Viti të shkojnë në këmbë nëpër shtegun e krijuar nëpër luginë, i cili shpesh ishte i pakalueshëm edhe për traktorë. Gjatë dimrit shpesh ishte e pamundshme të largohesh nga fshati për muaj të tërë. Në Lubishtë ishin fare të rrallë fshatarët që kanë arritur të arsimohen apo gjejnë vende pune gjetiu

⁵⁶ Susan Woodward, *Socialist Unemployment*, 1995, f. 74.

⁵⁷ *Ekonomia e RS të Serbisë, The Economy of the Socialist Republic of Serbia*, 1988.

në Kosovë. Lubishta kaloi nga zhvillimi i pamjaftueshëm para socializmit në varfëri pas socializmit pa ndonjë periudhë të ndërmjetme të modernizimit.

Ndryshe ishte situata në Cërrcë dhe komunën të cilës ai fshat i përkiste (Istogut). Kur Imer Maxharraj u bë një nga djemtë e parë të fshatit që ndiqte karrierë akademike – duke kaluar 8 vite në shkollën e mesme të Istogut para se të studionte bujqësinë në Beograd – ai përbënte një përjashtim nga rregulli. Deri në luftën e dytë botërore në Kosovë nuk ka pasur shkolla në gjuhën shqipe. Deri në vitet e 60ta ekzistonin fare pak shkolla të mesme. Pasi që shkollimi ishte parakusht për çfarëdo vendi pune me pagë, shqiptarët ruralë nuk mund të ishin pjesë e ekonomisë formale edhe për shkak të mosnjohjes së gjuhës serbe. Për fshatarët shkollimi nënkuptonte paraprakisht mësim të gjuhës dhe kulturës serbe, gjë që shumë prej tyre e rezistonin.

Nga vitet e 60ta filloi një fushatë e fuqishme për zhdukje të analfabetizmit dhe shumë djem të bujqve filluan të vijnë shkollimin e mesëm. Filloi një qasje e re ndaj shkollimit: “*veç me shkollë ka ardhmëri*”. Në mendjen e popullit shkollimi konsiderohej alternativë e migrimit, dhe filloi të shihet si rrugë më e lehtë dhe e preferuar drejt sigurisë ekonomike.

Kjo nxiti një revolucion të pritjeve, të cilat përshkruhen nga Berit Backer nga kujtimet e saj prej fshatit Isniq në perëndim të Kosovës gjatë viteve të 70ta. Sipas Backerit gjasat e gjetjes së punësimit me pagë pa shkollim adekuat ishin të barabarta me zero:

“Njerëzit e shohin shkollimin si shteg drejt modernizimit. Kjo është veçanërisht rezultat i ngritjes së statusit të gjuhës shqipe në vitin 1968 dhe përdorimit të saj në shkolla dhe administratë, si dhe hapjes së Universitetit të Prishtinës në vitin 1969.”⁵⁸

Sipas Backerit, fshatarët e shihnin shkollimin si ‘investim mjaft të sigurt’ – shprehje kjo e cila pasqyron optimizmin e viteve të 70ta.

Në Cërrcë, komunizmi krijoi vende të reja pune. Në vitin 1989, 60 fshatarë kishin gjetur punë në kompani socialiste ndërsa 40 tjerë ishin punësuar në institucione publike: shkolla, polici dhe spital të Istogut. Pesë kooperativa socialiste shërbenin si lidhje e bujqve lokalë me tregun. Ekzistonte një institut i veterinarisë, një kompani e ujitjes dhe një fermë peshku (Trofta). Kombinati bujqësor menaxhonte 2,145 hektarë tokë dhe vreshta, njëmijë kokë bagëtie, 18,000 derra dhe një fabrikë për prodhimin e koncentratit për ushqim të tyre.

Megjithatë, komunizmi nuk arriti të ndryshojë karakterin rural të Kosovës perëndimore. Në qytetin e Istogut vërehej fare pak industrializim i vërtetë: një fabrikë e përpunimit të drurit (Radusha) u hap në vitet e 50ta, në të cilën në vitin 1989 ishin të punësuar 76 persona që prodhonin dyer dhe dritare;⁵⁹ një fabrikë e tekstilit u hap në vitet e 60ta, e në të 225 punëtorë prodhonin penj.⁶⁰ Një fabrikë e madhe e pjesëve për automobila (Ramiz Sadiku) e hapur në Pejë, rreth 30 minuta larg me veturë, absorboi një pjesë të fuqisë punëtore të pakualifikuar. Megjithatë, në vitin 1981 rreth 50,000 banorë të komunës së Istogut kishin jo më shumë se 3,000 vende pune jashtë bujqësisë dhe vetëm 250 sish në industri. Në vitin 1989, mbi 70% të produktit shoqëror të komunës së Istogut gjenerohej në bujqësi.⁶¹

⁵⁸ Berit Backer, *Behind Stone Walls – Changing Household Organisation Among the Albanians of Kosova*, 1979, f. 40.

⁵⁹ Baza e të dhënave të NSH e Departamentit për Tregti dhe Industri të UNMIK-ut, 26 gusht 2002.

⁶⁰ Po aty.

⁶¹ Vjetari statistikor i RSF të Jugosllavisë, 1991, Beograd 1992, f. 656.

Tabela: Premtimi i thyer i socializmit në Kosovë⁶²

| Viti | Popullsia | Popullsia e moshës së punës | Vende të punës jashtë bujqësisë (proporcioni me popullsinë e moshës së punës) |
|------|-----------|-----------------------------|-------------------------------------------------------------------------------|
| 1953 | 813,000 | 433,000 | ... |
| 1963 | 1,021,000 | 529,000 | 77,658 (14.7%) |
| 1973 | 1,329,000 | 682,000 | 120,168 (17.6%) |
| 1983 | 1,676,000 | 909,000 | 198,484 (21.8%) |
| 1989 | 1,939,000 | 1,102,000 | 243,441 (22.1%) |

Shtimi i shpejtë i popullsisë tejkalonte aftësinë e ekonomisë së Kosovës për të krijuar vende pune. Edhe pse proporcioni i vendeve të punës jashtë bujqësisë për fuqinë punëtore të vendit u ngrit nga 18 në 22% viteve të 70ta, ai qëndroi në po të njëjtat përmasa gjatë të 80tave (shih tabelën 4 më lartë). Jo më shumë se 22% të fuqisë punëtore kishte vend të punës jashtë bujqësisë (e cila në masë të gjerë realizohej për mbijetesë).

Kolapsi i ekonomisë jugosllave, dëbimi nga puna i shqiptarëve prej Millosheviqit dhe rënia e Jugosllavisë e kthyen prapa edhe më tej atë pak përparim që ishte arritur. Mundësitë për punësim me pagë u zhdukën pothuajse fare, duke kthyer fshatrat në gjendje në të cilën gjendeshin breza më parë. Shumë të rinj (dhe disa të reja) që kishin investuar në shkollim u ndjenë të mashtruar nga mënyra si u zhvilluan këto ngjarje.

“Një i ri mbaron shkollën e mesme dhe regjistrohet në zyrë të punësimit por kjo nuk jep rezultat. Shpesh të tillët nuk kanë çfarë të bëjnë në shtëpi – grumbullojnë pak dru, korrin pak drithë. Ata nuk dinë kujt t’i drejtohen. Edhe nëse e kryejnë fakultetin do të përfundojnë si punëtorë fizikë jashtë vendit.”⁶³

Trendi i mosvijimit të shkollimit formal gjatë viteve të 80ta u përhap në veçanti për vajzat nga fshati, tek të cilat më pak se një në pesë kryente shkollën fillore. Sipas Janet Reineck, e cila qëndroi në Opojë nga fundi i viteve të 70ta, 40% të nxënësve të shkollave të mesme ishin vajza. Dhjetë vite më vonë, në vitin 1988, kjo përqindje ra në 4.5.

Familja Fejzaj nga Cërrca ilustron më së miri premtimin e dështuar të viteve të 70ta. Në vitin 1970 kur në Cërrcë nuk mund të gjendej vend pune me pagesë, i riu Smajl Fejzaj iu përgjigj konkursit të vendosur në zyrën lokale të punësimit për një vend pune në një fabrikë në Shtutgart të Gjermanisë, duke lënë familjen e tij prapa. Pagat e tij financuan blerjen e tokës bujqësore dhe kullosave malore. Me më shumë ushqim për sezonin e dimrit dhe me më shumë kullosa për verë, familja arriti të shtojë numrin e bagëtive dhe filloi prodhimin e kajmakut dhe djathit për shitje.

Katër djemtë e Smajlit kishin ambicie më të larta. Ata të gjithë kryen shkollën e mesme dhe shpresonin se do të gjejnë vende pune në fabrika shoqërore apo në administratë publike. Por, vetëm djali i madh e kishte këtë fat, i cili për disa vite punoi në një ndërmarrje komunale. Djali i tretë iku në Gjermani në vitin 1989 dhe arriti të marrë letrat e qëndrimit në vitin 2002 pas 13 vitesh në Gjermani. Djali më i ri kreu fakultetin në Universitetin e Prishtinës. Në vitin

⁶² Burimi: Vjetari statistikor i RSF të Jugosllavisë, 1991, f. 414. Fuqia punëtore në RSFJ përfshinte meshkujt mes 15 dhe 64 vjeç dhe femrat mes 15 dhe 59 vjeç.

⁶³ Janet Reineck, *The Past as Refuge*, 1991, f. 167.

2001 familja ia gjeti një grua ‘me letra’, një vajzë nga një fshat i afërm që punonte dhe jetonte në Zvicër.

Djali i dytë, Faiku, hyri në Gjermani në mënyrë ilegale në vitin 1994, me ndihmën e trafikuesve. Me të arritur, Faikut iu dha leja e tolerimit. Ai punoi në mënyrë ilegale dhe u arrestua dy herë gjatë inspektimeve të punës nga policia gjermane. Ai dhe familja e tij morën urdhërin për largim nga Gjermania në vitin 2003. Pas disa muajsh, një natë policia u trokiti në derë, e arrestoi tërë familjen dhe i deportoi ata. Në shkurt të vitit 2006, Faiku vdiq si pasojë e një infarkti në moshën 44-vjeçare. Babai i tij kishte vdekur në vitin 2002 rrugës për në Aeroportin e Prishtinës ku ishte nisur për t’iu kthyer punës së tij në Shtutgart.

Fati i katër vëllezërve Fejzaj përmbledh historinë e Kosovës rurale: bujqësi tradicionale deri në vitet e 60ta, pak shpresë për modernizim gjatë viteve të 70ta, stagnim gjatë viteve të 80ta dhe eksod gjatë viteve të 90ta. Këta katër vëllezër filluan me të njëjtin shkollim dhe të njëjtat mundësi, por nuk arritën që të njëjtat t’i shfrytëzojnë fare në ekonominë lokale. Sot dy prej tyre i kanë punët mirë në Gjermani dhe Zvicër. I treti ka vështirësi dhe jeton kryesisht nga pensioni gjerman të cilën e merr si e vejë nëna e tij. Gruaja dhe katër fëmijët e Faikut kanë ngelur pa të hyra dhe shpresojnë se vëllezërit e Faikut do vazhdojnë t’i përkrahin ata.

Premtimi i viteve të 70ta – shkollimi, punësimi me pagë dhe një standard solid i jetesës në Kosovë – u dëshmuar i paqenë për shumicën e fshatarëve në Kosovë. Ata në numra të mëdhenj u detyruan të migrojnë, duke konsideruar këtë si të vetmen strategji për mbijetesë. Duke qenë se shteti nuk ishte i pranishëm – dhe kur ishte shpesh ishte armiqësor ndaj tyre – familja e madhe tradicionale përbënte të vetmin institucion që ofronte mbrojtje nga varfëria.

D. Regjionet e braktisura nga punëtorët

Në vitin 2005, në Lubishtë së paku 118 shtëpi financoheshin nga remitancat. Nga 97 shtëpi që kishin traktor, 91 na thanë se paratë për blerjen e tij janë sjellë nga jashtë. Nga 147 shtëpitë që posedonin veturë, 137 i kishin blerë me para të transferuara nga mërgata. Thënë shkurt, pa transfere nga jashtë në këtë fshat nuk do të kishte pothuajse fare vetura, traktorë apo shtëpi të reja. Në Cërrcë, së paku 14 nga 30 traktorët ishin blerë me para të fituara jashtë vendit. Nga 100 shtëpi të cilat kishin vetura, 45 ishin blerë nga remitancat. Remitancat kishin paguar edhe rindërtimin e fshatit: së paku 79 shtëpi ishin rindërtuar apo ndërtuar me para nga diaspora, mesatarisht me nga 30,000 euro për shtëpi.

Ne kemi kalkuluar kontributin që remitancat japin në të ardhurat e gjithmbarshme në para të gatshme në fshatrat Lubishtë dhe Cërrcë (shih Shtojcën 3). Në Lubishtë, varësia nga remitancat është tejet e lartë: 60% të parave të gatshme vijnë nga transferet dhe pensionet jashtë vendit. Në Cërrcë, si fshat më i pasur, remitancat përbëjnë vetëm 27% të të ardhurave të gjithmbarshme. Edhe pse Cërrca ka më shumë bashkë-fshatarë jashtë vendit, në Lubishtë ka më shumë ekonomi familjare që marrin remitanca (shih Shtojcat 1 dhe 2).

Megjithatë, ndërtimi i shtëpive apo blerja e veturave nuk gjeneron rritje të qëndrueshme. Atëherë, cili ka qenë ndikimi më i gjerë i migrimit në strukturat ekonomike të të dy komuniteteve?

Për Lubishtën dhe Cërrcën, si edhe për tërë Kosovën, vitet e 90ta ishin epokë e migrimit masiv. Emigrantët e parë u larguan si gastarbajterë që në fillim të viteve të 70ta, ndërsa që migrimi vazhdoi me një hap të caktuar edhe gjatë të 80tave. Megjithatë, pikërisht në vitet e

90ta, që karakterizohen me kolaps ekonomik të Jugosllavisë dhe represion të regjimit të Millosheviqit, migrimi u shtua në mënyrë dramatike. Nga Lubishta viteve të 70ta ishin larguar 38 persona, viteve të 80ta 116 ndërsa viteve të 90ta 242 sish. Ndërsa shumica e emigrantëve nga Lubishta morën rrugën e Zvicrës, numri më i madh i banorëve të Cërrcës ikën drejt Gjermanisë.⁶⁴ Nga Cërrca rrugën e migrimit e morën 36 persona gjatë viteve të 70ta, 41 gjatë të 80tave dhe 204 gjatë të 90tave.

Që nga viti 1999 përvoja e këtyre dy fshatrave me migrim ka ndryshuar shumë. Në Lubishtë, migrimi është ngadalësuar dukshëm në krahasim me vitet e 90ta, por ka mbetur pozitiv. Deri në vitin 2005 në këtë fshat ka pasur 17 kthime vullnetare dhe 16 deportime.⁶⁵ Gjatë kësaj periudhe, 39 persona ikën nga Lubishta, duke rezultuar me emigrim pozitiv të 6 personave. Arsyeja kryesisht qëndron në faktin se diaspora e Lubishtës është përqendruar kryesisht në Zvicër, e cila nuk kishte vendosur që t'i kthejë kosovarët pas vitit 1999 (siç kishte bërë Gjermania).

Në Cërrcë, viti 1999 shënonte pikën kur migrimi ishte negativ për herë të parë në tërë historinë e këtij fshati, duke qenë se në këtë vit Gjermania filloi riatdhesimin e kosovarëve. 45 persona u kthyen 'vullnetarisht' në mes 1999 dhe 2005, ndërsa 31 tjerë u deportuan. Gjatë kësaj periudhe 20 persona arritën të lëshojnë fshatin. Si rezultat i drejtpërdrejt i kësaj, 33 ekonomi familjare humbën burimet e remitancave të tyre.

Epoka e migrimit për qëllime punësimi nga Kosova ka përfunduar si për Zvicrën dhe Gjermaninë, ashtu edhe për pjesën tjetër të Evropës. Që nga viti 1999, e vetmja rrugë legjitime e migrimit është ajo e bashkimit familjar. Vetëm ata që kanë anëtarë të familjes së afërt në diasporë mund të ndjekin këtë rrugë.

Çfarë ndikimi pati dalja masive e njerëzve gjatë viteve të 90ta në ekonominë dhe jetën shoqërore në këto dy fshatra? Ekonomistja amerikane, Jane Jacobs, duke diskutuar mbi 'regjionet të cilat braktisen nga punëtorët' thotë se kontributi i remitancave në zhvillim është i vogël. Duke analizuar valët e mëparshme të migrimit për punësim nga Jugosllavia ajo vërente:

“Remitancat, për aq sa zgjasin, lehtësojnë varfërinë në regjione të braktisura... paratë blejnë të mira nga importi për njerëzit dhe institucionet, të cilët po të mos ishin remitancat, do duhej të jetonin pa ato të mira, por kjo është e tëra... remitancat nuk kanë fare ndikim në kthimin e stagnimit në zhvillim.”⁶⁶

Në Lubishtë nga 842 banorët e moshës së punës vetëm 134 (16%) kanë ndonjë lloj punësimi apo të hyra të rregullta, duke shënuar kështu një normë tejet të ulët të punësimit. Në Cërrcë jetojnë 766 banorë të moshës së punës. Nga ta, 231 thonë se kanë ndonjë lloj të të ardhurave të rregullta. Vlerësimi i vendeve të punës aktualisht zbulon se kemi të bëjmë me një regjion në depresion të rëndë ekonomik. Vendet e punës në industri nuk ekzistojnë më. Bujqësia komerciale është në kolaps të plotë. Punët në ndërtimtari, shumë prej të cilave nuk janë të rregullta, si dhe puna në sektor publik janë dy burimet kryesore të të ardhurave.

Investimet kapitale të kryera falë financimeve nga remitancat nuk kanë rezultuar me ndryshim të strukturave ekonomike, do të thotë nuk u kanë ndihmuar njerëzve që të bëjnë gjëra të reja

⁶⁴ Datat e largimit nuk mund të përcaktoheshin për të gjithë anëtarët e familjeve që janë jashtë vendit; përveç kësaj, një numër i tyre janë lindur jashtë vendit.

⁶⁵ Këto riatdhesime u kryen nga Gjermania, Franca dhe Austria.

⁶⁶ Jane Jacobs, *Cities and the Wealth of Nations*, 1984, f. 75.

apo edhe gjëra të vjetra vetëm në mënyra tjera. Gjendja e bujqësisë e ilustron më së miri këtë situatë.

Një numër i madh i traktorëve janë blerë përmes remitancave. Megjithatë, fermat e familjeve janë duke prodhuar gati ekskluzivisht për konsum vetanak. Ato prodhojnë misër për të ushqyer bagëtitë të cilat u japin produktet e qumështit, apo grurë për të gatuar bukë. Nuk ka specializim apo teknika të reja bujqësore. Blerja e traktorëve thjeshtë ka rezultuar me ferma të tejkapitalizuara të shfrytëzuara për konsum vetanak.

Kjo është pjesërisht rezultat i fragmentimit të tokës. Qefser Qahili nga Lubishta ka pesë viça, 3 lopë qumështore dhe një ka. Në tokën e tij prodhon mjaft miell për të gatuar 10 muaj. Por jeta është duke u bërë çdo herë e më e shtrenjtë. Para luftës një litër benzinë kushtonte 0.30 euro, në vitin 2004 kushtonte 0.70 euro ndërsa tani kushton 1 euro. Çmimi i plehrave u ngrit nga 8 në 12 euro për një thes 50kg. Qefseri ankohet për këtë:

“Nëse shteti do të na jepte benzinën me çmime më të ulëta situata do të ishte më e mirë. Apo, po të kishim mundësi të marrim kredi. Por, ne nuk mund të marrim kredi sepse askush në familjen time nuk ka punë të përhershme me pagë. Vetëm vëllai im ka kontratë njëvjeçare dhe pagë të ulët.”

Për të mbijetuar në bujqësi ai duhet të blejë toka të reja të cilat shiten nga serbët. Por tokat e tilla janë të shtrenjta dhe mund të blihen vetëm me kursime të cilat ai kurrë nuk do të mund t'i grumbullojë. Te ardhurat nga bujqësia në Kosovë janë më të ulëta se shpenzimet. *Shpenzimet* mesatare vjetore për fermë janë 658 euro. E të *ardhurat* mesatare vjetore të raportuara për fermë janë €507.⁶⁷

Në Cërrcë, ekonomitë familjare kanë 1.14 hektarë tokë. Vetëm 2 fermerë kanë më shumë se 10 lopë, të cilat vazhdojnë t'i dërgojnë në kullosa malore gjatë verës. Kooperativat socialiste nuk janë më aty për të përkrahur fermerët me blerje të prodhimit apo marketing të produkteve. Pak pas luftës, rreth 10 persona në fshat filluan të punojnë në tregun e gjelbër më të afërt, duke tregtuar pemët dhe perimet e tyre por edhe disa të importuara. Vetëm katër prej tyre kanë vazhduar këtë veprimtari. Skender Kaliqani, ish-drejtor i kooperativës socialiste, është i vetmi që ka specializuar në fushën e agrobiznesit në këtë rajon. Ai menaxhon një fermë të pulave, duke ua shitur vezët shitësve me pakicë në Istog, apo edhe përmes shitores së tij.

Të dyja fshatrat ilustrojnë qartë se Kosova nuk ka politika efektive bujqësore apo të zhvillimit rural. Në mungesë të përkrahjes nga shteti, remitancat nuk mund të çojnë fermerët lokalë mbi nivelin e tyre aktual të luftës për mbijetesë.

Në sektorin e ndërmarrjeve, shumica e bizneseve private shfrytëzojnë kapitalin e fituar jashtë vendit, por ka fare pak shembuj të bartjes së sukseshme të shkathtësive të fituara jashtë vendit në ekonominë lokale. Në Cërrcë, çdo investim i dalluar në sektorin privat u financua nga fitimet e nxjerra jashtë vendit. Nga ata pak ndërmarrës që janë në këtë fshat, shumica janë të kthyer nga jashtë vendit. Ngjashëm është situata edhe për ato pak biznese që funksionojnë në Lubishtë. Megjithatë, edhe këto investime kanë bërë fare pak për të ndryshuar trajektoren e stagnimit në këto dy fshatra.

Disa vitet e para pas luftës kishte një bum të ndërtimit (që nuk është befasuese duke marrë parasysh faktin se në Cërrcë 90% të shtëpive ishin të shkatërruara). Kompania më e madhe

⁶⁷ Fermat e vogla (nën 2 ha) raportojnë shpenzime prej €578 dhe të hyra prej €408. Burimi: ZSK: Anketa e Buxheteve të Ekonomive Familjare Bujqësore 2004, f. 30.

ndërtuese lokale, që punësonte 12 persona, u themelua në vitin 2000 kur dy vëllezër u kthyen nga jashtë me kapital themelues prej 200,000 euro. Megjithatë, ndërtimi i shtëpive kryesisht u krye deri në vitin 2004, duke shkaktuar tkurrje të shpejt të këtij sektori.

Pjesa e mbetur e sektorit privat në Cërrcë përbëhet nga mikrondërmarrje të menaxhuara nga familje të ndryshme: shitore, taksi, mekanikë të veturave. Ekzistojnë disa restorante dhe kafe, një pishinë dhe një internet kafe. Asnjë nga kompanitë nuk kërkojnë ndonjë shkathtësi specifike.

Epoka e migrimit masiv tani është duke u përmyllur, por nuk ka arritur të ndryshojë strukturën e ekonomisë dhe nuk ka gjeneruar ndonjë cikël të qëndrueshëm zhvillimi. Në aspekt ekonomik, remitancat thjeshtë kanë sjellë më shumë nga ato që veç kanë qenë të pranishme në ekonominë lokale: shërbime ndërtimtarie, shitore, kafe, taksi, mekanikë veturash dhe pompa benzine. Ato kanë shërbyer si ndihmesë për të ardhurat familjare, duke bërë që familjet tu kënaqen mallrave konsumuese moderne, si dhe i kanë mbajtur familjet e varfra një hap larg mjerimit. Megjithatë, siç vëren edhe Jane Jacobs, nëse remitancat ndërpriten, këto përfitime do të humbin me shpejtësi të paparë.

“Taksitë, të blera me para të kursyera për vite të tëra të kaluara në Rotterdam, e të importuara në fshatra të varfra të Afrikës veriore apo Evropës jugore, eventualisht do të prishen dhe do të jenë të pariparueshme, ndërsa ndërkohë pronari i tyre nuk ka arritur të akumulojë mjaft para për të financuar një veturë tjetër për ta zëvendësuar atë. Kësisoj shkatërrohen bizneset në fshatra. Problemi është se ekonomitë rurale nga të cilat këta emigrantë ambiciozë vijnë e në të cilat ata zakonisht kthehen, janë tepër stagnante dhe jofleksibile, andaj nuk mundësojnë realizimin e aktiviteteve të reja.”⁶⁸

Si rezultat i kësaj, problemet ekonomike dhe sociale të cilat e kanë bërë migrimin domosdoshmëri të së kaluarës janë ende të pranishme sot. Në Cërrcë, 35% e popullsisë është nën moshën 16 vjeçare. Çdo vit, nga 30 banorë arrijnë moshën e punës por nuk kanë ndonjë gjasë reale për të gjetur punë në komunitetin e tyre. Pa sigurinë që e ofron migrimi i vazhdueshëm, presionet sociale do të akumulohen çdo herë e më shumë. Megjithatë, Cërrca është fshati që i ka punët më së miri në zonat rurale të Kosovës.

E. Gratë rurale pa të drejta

Një nga realitetet sociale që dallon Kosovën nga pjesa tjetër e Evropës sot është shkalla e saj jashtëzakonisht e ulët e punësimit të grave. Në Lubishte, janë vetëm dy gra të punësuarra – më pak se 1%. Në Cërrcë, 35 gra janë të punësuarra, duke shënuar një shkallë punësimi prej 9% nga radhët e grave të moshës së punës. Kjo është më afër mesatares së Kosovës.

Mundësitë sociale për gratë vazhdojnë të jenë të kufizuara si pasojë e vlerave tradicionale. Shumica e grave marrohen para moshës 30 vjeçe dhe nëse nuk marrohen, ato konsiderohen turp për familjen. Shkurorëzimet janë jashtëzakonisht të rralla, për shkak të një kombinimi kufizimesh sociale dhe ekonomike. Gratë kanë të drejta të barabarta me burrat sipas ligjeve që rregullojnë trashëgiminë, por shumë rrallë kërkojnë t’i realizojnë të drejtat e tyre. Në Lubishtë, bashkëbiseduesit mund ta kujtonin vetëm një rast kur një grua kishte trashëguar pronë, në një rast të veçantë ku familja nuk kishte pasur djalë për ta trashëguar atë. Disa fshatarë e konsiderojnë ligjin zyrtar për familjen si ‘ligj serb’ i cili nuk është në përputhje me traditat e tyre.

⁶⁸ Jane Jacobs, *Cities and the Wealth of Nations*, 1984, p 77.

Shkalla jashtëzakonisht e ulët e punësimit tek gratë krijon një nga problemet më të mëdha ekonomike të Kosovës – një numër tejet të lartë të personave të varur ekonomikisht nga të tjerët. Mesatarisht, çdo kosovar i punësuar duhet të mbështesë 4.78 persona të papunë.⁶⁹

Punësimi i ulët është pasqyrim i qëndrimeve tradicionale mbi rolin e gruas, të cilat po dëshmohej të jenë të vështira për t'u larguar. Në vitet e 1970-ta, Berit Backer theksoi se shkollimi paraqet shpresën kryesore për t'i ndryshuar këto qëndrime.

“Ndikimi i grave sot nuk është edhe aq shumë rezultat i rebelimit të shtëpiakeve sa është ndikimi i shkollimit tek vajzat... Më 1975 më shumë vajza se djem vijonin shkollimin e mesëm.”⁷⁰

Por ky trend nuk i mbijetoi fillimit të krizës ekonomike të vitit 1981. Përqindja e grave pa shkollim të kryer fillor është mbi tri herë më e lartë se ajo për burrat. Në vitin 2005, 70% e grave kishin të kryer vetëm shkollim fillor ose më pak.⁷¹

Kjo bën që gratë të jenë jashtëzakonisht të varura në familje tradicionale. Siç theksoi Janet Reineck në fund të viteve të 1980-ta, një grua rurale në Kosovë:

“Ka pak gjasa të mbijetesës ekonomike në vete. Ajo është e destinuar të jetë ekonomikisht dhe emocionalisht e varur nga burri i saj dhe familja e tij. Për të jetuar në paqe në mesin e tyre ajo duhet ta fitojë respektin e familjes dhe komunitetit. Për ta fituar këtë respekt, ajo duhet t'i përmbushë pritjet kulturore të cilat informojnë çdo pjesë të jetës së saj.”⁷²

Sipas Hyre Azizit, sekretare në shkollën fillore në Lubishte, arsyet kryesore pse kaq pak vajza nga Lubishta – aktualisht rreth dhjetë – vijojnë mësimin në shkolla të mesme janë varfëria e shumë familjeve dhe mungesa e çdo perspektive reale të grave për tu punësuar apo fituar mjaftueshëm me gjithë shkollimin. Shumica e vajzave, thekson ajo, shohin se ato gra që tani punojnë si mësuese apo infermiere fitojnë aq pak sa që mbesin të varfra. Shpeshherë prindërve më të arsimuar, të cilët do të ishin më me gjasë t'i dërgojnë fëmijët e tyre në shkollim të lartë, u mungojnë mjetet financiare për ta bërë këtë. Ata që kanë më shumë para, përkatësisht familjet me anëtarë jashtë vendit, nuk e vlerësojnë arsimin në të njëjtën mënyrë – veçanërisht meqë arsimit nuk rritë statusin social të vajzave. Hyrja thotë:

“Një vajzë me letra është më me vlerë, ajo gëzon status më të lartë shoqëror, sesa një grua mjeke apo inxhinierë që punon këtu në Kosovë. Ka pak arsye që vajzat t'i vazhdojnë studimet ... Disa madje e braktisin mësimin dhe heqin dorë nga diploma edhe nëse janë vetëm 2-3 provime larg nga përfundimi, nëse kanë shanse të marthohen me një person me letra. Arsimit ka humbur vlerën e tij.”⁷³

Fikrete Dalipi, e bija e një zdrukthëtari, është njëra nga vetëm dy gratë nga Lubishta që aktualisht studion në universitet. Ajo ka përfunduar një semestër në Cactus, njërin nga fakultetet e reja private në Prishtinë. Secili semestër i kushton 270 Euro. Fikretja gjithashtu paguan 60 Euro në muaj për qiranë e banesës që e ndan me disa vajza të tjera në Prishtinë. Shoqja e saj Melihatja, babai i së cilës drejton njërin nga tre dyqanet në Lubishtë, do t'i bashkohet asaj për semestrin e ardhshëm, duke studiuar ekonomi në universitetin privat Fama

⁶⁹ ZSK Anketa e Fuqisë Punëtore 2004, f. 15.

⁷⁰ Berit Backer, *Behind Stone Walls*, 1979, f. 100.

⁷¹ ZSK, *Anketa e Buxheteve të Ekonomive Familjare Bujqësore*, 2004.

⁷² Janet Reineck, *The Past as Refuge*, 1991, f. 11.

⁷³ Intervistë e ESI, 8 shtator 2006.

që do t'i kushtojë 1,300 Euro në vit. Këto të dyja janë gratë e para nga Lubishtja që do t'i ndjekin studimet në dekadën e fundit. Pa kredi bankare ose bursa në dispozicion, kostot e studimit janë përtej mundësive për shumicën e familjeve.

Disa fshatarë, me kosto dhe sakrificë të madhe, përpiqen të sigurojnë shkollim si rrugë drejt përparimit për fëmijët e tyre. Shumica nuk e bëjnë këtë. Sipas drejtorit të shkollës fillore në Lubishtë, një baba i cili dëshiron që fëmijët e tij të studiojnë do të duhet të shesë tokë për ta financuar shkollimin. Nuk ka sistem të bursave për familjet rurale. Në këto kushte, fakti që askush nuk pret që gratë të punojnë është arsye e mirë që të kursejnë duke mos i dërguar ato në shkollë.

IV. KUR PATRIARKATI SHPARTALLOHET

A. Familjet, mbijetesja, mirëqenia

Në vitin 2006, autori gjerman Frank Schirmacher publikoi një libër – *Minimum* – i cili përdorë Grupin Donner – një grup të ardhacakëve që nisen me qerre në udhëtimin 2000 miljesh nga Illinois për në Kaliforni, në vitet e 1840-ta – si një metaforë për krizën me të cilën përballet shoqëria evropiane në shekullin 21.

Në vitin 1994, antropologu amerikan Donald Grayson shkroi një studim shkencor mbi këtë grup, i cili hasi në një fund tragjik në dëborën e Sierra Nevadës. Pasi kaluan shkretëtirën e Liqenit të Salt Lake, grupi u bllokua nga dëbora e parakohshme në male. Në pamundësi për të shkuar përpara ose prapa, 40 nga 87 prej tyre humbën jetën para se t'u arrinte ndihma në pranverë. Kjo përfshinte pothuajse të gjithë të rinjtë të cilët kishin udhëtuar pa familje. Grayson theksoi se kishte korrelacion direkt midis madhësisë së familjes dhe gjasave të mbijetesës:

“Burrat që mbijetuan kishin udhëtuar me familjet madhësia e të cilëve ishte mesatarisht 8.4 anëtarë. Burrat që nuk mbijetuan udhëtonin me familjet prej mesatarisht 5.7 individë. Gratë e kësaj moshe që mbijetuan udhëtonin me familje madhësia e të cilave ishte mesatarisht 10.1 anëtarë... grupet me më shumë anëtarë duket se u kanë dhënë mbështetje jetësore anëtarëve të grupit Donner”⁷⁴

Schirmacher flet për familjen si *Überlebensfabrik* (“motor mbijetese”), e cila gjithnjë e më shumë po kërcënohet nga normat e lindjeve që në Evropë janë në rënie të ashpër.⁷⁵ Ai ofron paralajmërimet e tmerrshme për një të ardhme në të cilën shumica e fëmijëve do të rriten pa vëllezër apo motra, dhe ku njerëzit do të zbulojnë në moshë të shtyrë se janë varur më tepër se që duhet në mirëqenien që ua siguron shteti.

Sot, vendet e reja anëtare të BE-së në Evropën Qendrore kanë disa nga shkallët më të ulëta të lindjeve në botë: 1.2 fëmijë për një grua në Republikën Çeke, Slloveni, Letoni dhe Poloni, shumë më ulët se 2.1, norma të nevojshme për ta mbajtur nivelin e popullsisë. Greqia, Italia dhe Spanja kanë pasur shkallë prej 1.3 dhe më të ulët për një dekadë. Siç theksoi me alarmim (dhe gabimisht) një artikull i kohëve të fundit: “asnjë vend evropian nuk është duke e mbajtur nivelin e popullsisë së tij përmes lindjeve.”⁷⁶

⁷⁴ Donald Grayson, Differential Mortality and the Donner Party Disaster, *Evolutionary Anthropology*, 1994, f. 157.

⁷⁵ Frank Schirmacher, *Minimum*, 2006, f. 39.

⁷⁶ IHT, “Europe, East and West, wrestles with falling birthrates”, 3 shtator 2006.

Megjithatë, vetëm një orë fluturimi larg Vjenës, familja tradicionale patriarkale është ende brenda normave. Në fakt, gjendja në Kosovën rurale sot paraqet imazh të kundërt nga ai në gjithë pjesën tjetër të Evropës, në Lindje dhe Perëndim. Në Kosovë, rritja e popullsisë vazhdon në shkallë prej 1.6% në vit.⁷⁷ Në këtë shkallë, popullsia dyfishohet brenda 43 vjetësh.

Në vend të mbylljes së shkollave fillore, siç ndodh sot në shumë fshatra gjermane, klasat shkollore në Kosovë organizohen në ndërrime për të përballuar kërkesën. Vështirë se gjendet një grua në Kosovën rurale më e vjetër se 30 vjeç që nuk është e martuar. Nuk ka pothuajse asnjë shkurorezim në zonat rurale. Nuk ka ekonomi familjare me vetëm një anëtar në viset rurale. Ashtu sikurse burrat e pamartuar të fortë që udhëtuan me grupin Donner dhe që vdiqën të parët, ata thjesht nuk do të mbijetonin.

Schirmmacher thekson se mënyra tejet ekonomike e të jetuarit bije ndesh me ‘ekonominë morale’ të familjes tradicionale, ku shërbimet jepen pa prituri shpërblim për to. Në fakt, në Kosovën rurale sot toka nuk shihet si aset ekonomik, por si mjet bazik për një familje. Punësimi jashtë familjes nuk është i zakonshëm.

Kosova gjithashtu spikatet me mungesë pothuajse të plotë të një shteti të mirëqenies që ofron siguri. Sistemi social i Kosovës e merr si të qenë mekanizmin e solidaritetit familjar në Ballkan. Ai nuk është dizajnuar për një shoqëri të familjeve nukleare. Në vitin 2005 asnjë familje nuk merrte ndihmë nëse kishte një të rritur *që mund të punojë*, qoftë në Kosovë qoftë jashtë vendit. Nëse i rrituri është në fakt i punësuar nuk ka rëndësi. I vetmi përjashtim nga ky rregull është për familjet që kanë më pak se 0.5 ha, askënd jashtë vendit dhe një fëmijë më të vogël se 6 vjeç. Këto familje mund të marrin një përfitim modest, deri sa fëmija ta arrin moshën 6 vjeçe.⁷⁸

Duhet paguar një çmim – në kuptim të zhvillimit ekonomik dhe të autonomisë individuale – për të pasur familjen tradicionale patriarkale si të vetmin burim të sigurimit social. Siç thekson edhe Hysen Maxharraj për ESI në Cërrcë:

“Kush në të vërtetë do të dëshironte të jetonte me të vëllain nën një çati, kur që të dy janë të martuar? Ne nuk jemi aq të ndryshëm nga ju në Evropën Perëndimore. Këtë organizim familjar e kemi vetëm nga nevoja.”

Megjithatë, përderisa nuk ka asnjë rrugë alternative për siguri ekonomike, vlerat tradicionale kanë tendencë që të mbijetojnë.

B. Si shpartalohet patriarkati

Në vitin 2004, në fshatin Gjylekare të komunës së Vitisë, vetëm 5 km larg Lubishtës, ESI-t iu tregua një letër e dërguar nga një fshatar i cili kishte emigruar në vitin 1971. Që nga viti 1971, ai i kishte blerë familjes së tij një kombajnë, dy hektarë tokë dhe disa automjete, si dhe kishte paguar ndërtimin e shtëpive të reja për secilin nga katër vëllezërit e tij. Në këtë letër, ai informoi vëllezërit e tij që nga tani e tutje, ai dëshiron të punojnë vetëm për veten e tij. Fundi i migrimit masiv, duke prerë rrjedhën e parave që vinin tek zonat rurale, do të rrisë presionin në familjet rurale duke sfiduar vlerat tradicionale dhe duke përshpejtuar krijimin e njësisive më të vogla familjare.

⁷⁷ Burimi: ZSK, Anketa Demografike dhe Shëndetësore 2003.

⁷⁸ Rexhep Rexhepi, përgjegjës për mirëqenie sociale në Lubishtë, për ESI, shtator 2006.

Historia moderne e Ballkanit tregon se edhe motori më i dëshmuar e mbijetesës – familja patriarkale – mund të prishet. Në kushte të caktuara, familjet patriarkale prishen, edhe në mungesë të ndonjë rruge alternative për siguri materiale. Me përfundimin e migrimit masiv, presionet në viset rurale të Kosovës po rriten me shpejtësi. Fshatrat e Kosovës, të cilat ka një kohë të gjatë që nuk janë ekonomikisht të vetëqëndrueshme, gjithashtu po bëhen gjithnjë e më të stërbushura. Si rezultat i rregullave të trashëgimisë, parcela mesatare e tokës është bërë e pamjaftueshme edhe për bujqësinë si mjet jetese. Në vitin 2006, 1,397,333 njerëz jetonin në zona rurale (73.2% e popullsisë së Kosovës)⁷⁹. Për çerek shekulli që nga viti 1981, popullsia urbane është rritur për 100 mijë ndërsa popullsia rurale për 220 mijë njerëz.⁸⁰ Janë zonat rurale ato ku popullsia e Kosovës vazhdon të rritet më shpejtë.

Në vitin 2004, Kosova kishte 117,967 ekonomi familjare bujqësore.⁸¹ Ndërmjet tyre, ato kishin vetëm 115,000 hektarë tokë nën kultivim.⁸² Pothuajse 90,000 të fermave të tyre janë më të vogla se 2 hektarë (mesatarja është 0,88 ha).⁸³ Një përqindje gjithnjë më e madhe e familjeve rurale nuk kanë tokë të mjaftueshme për t'i përmbushur nevojat e familjeve për miell gruri për tërë vitin. Është thjesht e pamundur për t'i ndarë pronat edhe më tej.

Si rezultat vijnë rritja e pakënaqësive dhe mosmarrëveshjeve. Lindin frustrime tek personat jashtë vendit, të cilët kanë arritur kufirin e kapacitetit dhe gatishmërisë së tyre për ta mbështetur familjen në fshat. Pakënaqësia është gjithashtu në rritje tek djemtë të cilët nuk dëshirojnë të kontribuojnë me të ardhurat e tyre të pakta për familjen e gjerë, por preferojnë të kontribuojnë tek familja e ngushtë.

Një nga studimet më të mira për ndikimin e krizës ekonomike në strukturat familjare është ai i kroates Vera Erlich, sociologe e cila ka studiuar ndryshimin e strukturave familjare në fshatrat jugosllave në fund të viteve të 1930-ta. I publikuar në vitet e 1960-ta, hulumtimi i saj tregon se si rritja e varësisë së familjeve fshatare në të ardhura në para të gatshme, rritja e popullsisë rurale dhe mungesa e mundësive për të migruar nga zonat rurale jashtë vendit ose në qytete, përfundimisht shkatërruan familjet tradicionale, duke i ndarë ato në njësi shumë më të vogla.

Pas analizës së të dhënave që i mbledhi nga 300 fshatra nga e tërë Jugosllavia në vitin 1938, Erlich gjeti se fshatrat në të cilat ende mbizotëronte *zadruga* (familjet të cilat përfshinin djem të martuar dhe familjet e tyre) mund të gjendeshin vetëm në fshatrat shqiptare dhe tek ortodoksët maqedonas. Në këto fshatra, “djemtë nuk ndahen nga babai i tyre, për sa kohë sa ai të jetë gjallë. Ndarjet e tillë konsiderohen si të turpshme në ekstrem”.⁸⁴ Atje, autoriteti i babait ishte i padiskutueshëm. Këto ishin komunitete të mbyllura rurale, të cilat mezi merrnin pjesë në ekonominë e parasë së gatshme. Ato gjithashtu ishin të izoluara edhe nga vështirësitë që shkaktonte Depresioni i Madh në pjesën tjetër të Jugosllavisë.

⁷⁹ Komunikimi me këshilltarin ndërkombëtar pranë Zyrës Statistikore të Kosovës Sasun Tsurunyan, 9 shkurt 2006 dhe 21 shkurt 2006.

⁸⁰ Në vitin 1981 1,171,812 persona jetonin në vise rurale, 73.9 % e popullsisë së gjithmbarshme. Vjetari Statistikor i Jugosllavisë, 1991, Beograd.

⁸¹ Ekonomitë familjare bujqësore që posedojnë dhe kultivojnë mbi 0.10 ha të tokave të punueshme apo që kanë nën 0.10 ha të tokave të punueshme por edhe ndonjë bagëti.

⁸² ZSK, Anketa e Buxheteve të Ekonomive Familjare Bujqësore 2004, f. 14.

⁸³ Në tërë Kosovën ekzistojnë 369 ekonomi familjare që ZSK i konsideron ‘ferma të mëdha’ me mesatarisht 25.5 hektarë tokë (që është e barabartë me sipërfaqen e një ferme të vogël në Gjermani).

⁸⁴ Vera Erlich, Family in Transition, 1966, f. 39.

Kudo tjetër, familja tradicionale ishte në “në faza të ndryshme të shpërbërjes”. Me rritjen e popullsisë, qytetet nuk ishin në gjendje ta absorbonin fuqinë e tepërt punëtore rurale.⁸⁵ Në të njëjtën kohë, Depresioni i Madh shkaktoi një rënie të çmimeve të produkteve bujqësore, duke shkatërruar shpejt të ardhurat nga bujqësia. Në tërë Jugosllavinë, kriza në fshatra nënkuptonte që deri në vitin 1939, standardi i jetesës kishte rënë nën atë që ishte një brez më parë.

“Mbizotëronte një atmosferë e dështimit, shpresave të mashtruara dhe pesimizmit. Fenomeni i kolapsit dhe rebelimi është përshtypja kryesore kur dikush studion marrëdhëniet familjare në gjendje të transformimit të shpejtë. Karakteristika më e zakonshme dhe gjithashtu më e rëndësishme e kësaj faze është mospajtimi apo përçarja në familjet që shfaqet papritmas.”⁸⁶

Konflikti gjithnjë më i madh midis djemve dhe etërve ishte shenjë se familja tradicionale ishte nën presion. Një raport nga një fshat afër Nikshiqit në Mal të Zi theksoi dimensionin ekonomik të kësaj sfide në hierarkitë tradicionale.

“Fshati u godit nga një valë e re e mungesës dhe varfërisë dhe, si rezultat, ishte vënë në rrezik pozicioni i më të moshuarve, e me këtë edhe ai i familjes. Sot, më shpesh se kurrë më parë, fëmijët lënë prindërit e tyre para kohe dhe nuk respektojnë asnjë nga dëshirat e prindërve.”⁸⁷

Erlich thekson se thyerja e autoritetit të kryefamiljarit të *Kooperativës* rezultoi në konflikte dhe dhunë në të gjithë Jugosllavinë rurale. “Në fazën e kalbjes së sistemit patriarkal, të drejtat e çdo anëtarit të familjes u bënë të pasigurta, prandaj të gjithë përnjëherësh luftonin për më shumë të drejta.”⁸⁸

Një grup i ngjashëm faktorësh ishin në funksion në Kroaci në fund të shekullit 19, kur atje filloi rënia e *Zadrugave*. Sikurse që theksoi ekonomisti kroat Rudolf Biçaniq:

“Për sa kohë që çdo gjë në shtëpi shkonte sipas zakoneve të vjetra, anëtarët e *Zadrugës* nuk e kritikonin të moshuarin, dhe as nuk e fajësonin atë për keqmenaxhim. Por, kur çmimi i produkteve agrare pësoi rënie, nuk mund të përmbusheshin të gjitha nevojat në sistemin e vjetër.”⁸⁹

A do të bëhet ky kapitull i historisë së Ballkanit pjesë e së ardhmes së Kosovës?

Për një periudhë të shkurtër në vitet e 1970-ta, dukej se kalimi nga familja tradicionale në familje të vogla urbane do të ishte graduale, e nxitur nga urbanizimi dhe mbështetja gjithnjë në rritje në paga nga puna. *Kështu* ka ndodhur në Prishtinë. Pastaj erdhën vitet e 1980-ta dhe të 1990-ta, të cilat sollën dy ndryshime: një mjedis gjithnjë më të pafavorshëm ekonomik dhe politik, dhe disponueshmëri të dërgesave në para të gatshme nga emigrantët. Familja tradicionale u rikthye në rolin e saj të vjetër, përmes vazhdimit të sigurimit të mjeteve të jetesës nga Zvicra dhe Gjermania. Ishin remitancat ato që i mundësuan familjes tradicionale që t’i mbijetojë rënies së ekonomisë blegtore dhe shoqërisë bujqësore që edhe e kishte lindur atë.

⁸⁵ Në vitin 1931 rritja e popullsisë shënonte mes 1.7 dhe 2.1 % në shumicën e provincave. Shih Kaser, 1995, f. 150.

⁸⁶ Vera Erlich, *Family in Transition*, 1966, f. 424.

⁸⁷ Po aty f. 69.

⁸⁸ Po aty f. 92: “Bijtë e fshatarëve shfaqin sjellje të pakonsideratë dhe dhunë jo në fazën patriarkale por në fazën kur hierarkia familjare dezintegrohet.”

⁸⁹ Rudolf Bicanic në veprën *Agrarna Kriza u Hrvatskoj 1873-1895*, e cituar nga Vera Erlich, *Family in Transition*, 1966, f. 50.

Historiani austriak Karl Kaser, ekspert lider i familjeve në Ballkan, paralajmëroi se në vitin 1995 “mund të supozojmë se sistemet e vlerave tradicionale janë vënë nën tension të madh nga proceset e modernizimit, që mund të çojë deri te një shpërthim nën kushtet e krizave sociale.”⁹⁰ Sot, të gjitha kushtet ekzistojnë në Kosovë për një shpërthim të tillë.

V. KONKLUDIM – FUNDI I NJË EPOKE?

Flitet shumë për *evropianizimin* e Kosovës si rrugë e vetme drejt përparimit. Por përveç nëse evropianizimi përfshin edhe migrimin për punë dhe qasje në tregjet evropiane të punës, ai do të mbetet asgjë më shumë se një slogan. Politika aktuale e BE-së – që të vazhdojë të investojë miliona euro për ta stabilizuar Kosovën dhe Evropën juglindore pa një zhvillim të qëndrueshëm dhe politika të migracionit – është e pakuptimt.

Kosova po përballlet me një realitet të ashpër. Që nga viti 2004, FMN-ja ka ngritur alarmin për këtë. Pas disa viteve të festimit të sukseseve të politikave ekonomike të UNMIK-ut, raportet e janë gjithnjë e më të qarta në paraqitjen e situatës së keqe ekonomike të Kosovës: Kosova “mund të hyjë në një rreth vicioz”; ajo ka “probleme të rrënjosura thellë”; situata është “e brishtë”; “e cenueshme”; dhe “e ardhmja e afërme, madje në skenarin më të mirë, nuk duket premtuese.”⁹¹

Deri më tani, vazhdimësia e lajmeve të këqija ekonomike nuk ka çuar deri te një vështrim më i afërt i trendeve ekonomike në zonat rurale. Dhe nuk ka shkaktuar debat serioz të ndikimit që ka politika evropiane e migracionit në Kosovën.

Qartas, nga ana e politikanëve të Kosovës, hapi i parë do të duhej të ishte përcaktimi i politikave të qëndrueshme ekonomike dhe sociale për zonat rurale. Politika bujqësore vazhdon të jetë marginale karshi debatit politik në vend.⁹² Çdo strategji kombëtare për zhvillim duhet ta trajtojë problemin e mundësive joadekuate dhe kostove të larta të arsimit të mëtejshëm në zonat rurale. Skemat e reja të financimit për t’u mundësuar studentëve nga vendet rurale, duke përfshirë gratë, mundësi për arsimim të mirëfilltë, duhet të jenë prioritet kombëtare.

Njëkohësisht, shtetet evropiane do duhej të punojnë me autoritetet kosovare në përcaktimin e skemave të migrimit me qëllim të punësimit në pjesët e Bashkimit Evropian të cilave u nevojitet fuqi punëtore, duke gjetur një mënyrë të pranueshme për shtetet e Evropës për ta realizuar këtë. Kjo do të përfshinte hapa konkret për t’u ndihmuar kosovarëve në sigurimin e qasjes në tregjet evropiane të punës.

Kosova do duhej të krijojë një institut kombëtar për të studiuar implikimet ekonomike, sociale dhe juridike të migrimit. Ky institucion do duhej të fokusohet jo vetëm në Gjermani, Austri dhe Zvicër, që janë destinacionit e preferuara të kosovarëve, por në tërë tregun evropian të punës. Ai do duhej të merret me studimin e përvojave me migrimin për punë nëpër botë dhe të llojë për qasjen e kosovarëve në tregje të punës. I njëjti do duhej të sigurojë informata për institucionet arsimore dhe politikëbërësit në Kosovë mbi nevojat e tregut evropian të punës dhe implikacionet e nevojave në fjalë në përgatitjen arsimore dhe trajnimet të cilat i ofrohen fuqisë punëtore në vend.

⁹⁰ Karl Kaser, *Familie und Verwandtschaft auf dem Balkan*, 1995, f. 16.

⁹¹ IMF, *Gearing Policies*, 2004, f. 5.

⁹² Christian Boese, Emil Erjavec, Miroslav Radnak, *Strategic Study – Support to Agricultural Sector in the Western Balkans*, Arcotrass, 2005.

Edhe qytetarët e viseve rurale të Kosovës edhe taksapaguesit evropianë meritojnë më shumë se një set politikash të cilat janë duke dështuar aktualisht dhe janë të destinuara të dështojnë në të ardhmen. Por, vetëm duke i rishqyrtuar politikat aktuale mund të arrihet qëllimi i synuar – stabilizimi i Ballkanit përendimor një herë e përgjithmonë pas dekadave të tëra me luftëra.

SHTOJCA I – Cërrcë në shifra (2005)

| | | | | | |
|--------------------------------------------|-------|-----|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----|---------|
| Popullsia e gjithmbarshme | 1,980 | | | | |
| Popullsia rezidente | 1,311 | | | | |
| Rezidentë gjetiu në Kosovë | 62 | | | | |
| Jashtë vendit | 607 | 376 | Gjermani | | |
| | | 72 | Zvicër | | |
| | | 42 | Austri | | |
| | | 38 | Suedi | | |
| | | 17 | Norvegji | | |
| | | 17 | Luksemburg | | |
| | | 16 | Belgjikë | | |
| | | 24 | <i>shtete tjera</i> (Francë, Kroaci, Australi, Mbretëri e Bashkuar, Itali, SHBA, Shqipëri) | | |
| | | 5 | nuk dihet | | |
| Gjithsej ekonomi familjare | 300 | 78 | të gjithë anëtarët jetojnë jashtë vendit | | |
| | | 8 | gjetiu në Kosovë | | |
| | | 55 | në Cërrcë me disa anëtarë jashtë vendit | | |
| | | 159 | në Cërrcë pa anëtarë jashtë vendit | | |
| Madhësia mesatare e ekon. familjare | 6.6 | | (përfshirë anëtarët jorezidentë) | | |
| Mosha e banorëve rezidentë | | 451 | 1-15 vite | | |
| | | 766 | 16-64 vite | | |
| | | 84 | 65 dhe më të vjetër | | |
| | | 10 | nuk dihet | | |
| Popullsia e moshës së punës | 766 | 376 | meshkuj | 194 | punojnë |
| | | 390 | femra | 35 | punojnë |
| Meshkuj dhe femra që punojnë | 229 | 83 | Sektor privat | | |
| | | 55 | Administratë publike | | |
| | | 39 | Në fermë (4 nga ta në prerje ilegale të druve) | | |
| | | 23 | Punë sezonale (kryesisht ndërtimtari) | | |
| | | 18 | Ndërmarrje shoqërore/Ndërmarrje publike | | |
| | | 11 | Oraganizata ndërkombëtare (gjashtë OJQ) | | |
| Vendet e punës në sektor privat | 83 | | 25 në ndërtimtari (tetë kryepunëtorë të ekipeve ndërtuese që punojnë kohë pas kohe, dymbëdhjetë në Gurrakuq, një në Istog, një moler, një vozitës i eskavatorit, dy punonjës në gurore në Cërrcë) | | |
| | | | 11 në tri fabrika të përpunimit të drurit, një prodhues të mobileve dhe parketeve; 2 vozitës taksi; 1 vozitës autobusi; 7 mekanikë të automobilave; 20 në nëntë kafe dhe restorante dhe një internet kafe; 8 në tregti (katër tregtar të skrapit, bagëtime dhe vezëve nga feramat e tyre; katër në shitore dhe pompa benzine); 5 punonjës fizikë; 1 roje; 1 në farmaci bujqësore; 1 në një organizatë kreditore; 1 inxhinier në kompani të TIK. | | |
| Asistenca sociale | 29 | | familje (me gjithsej rreth 129 anëtarë) | | |
| | | | Transferi i gjithmbarshëm për muaj: € 1,792 | | |
| Pensione të Kosovës | 80 | | Transferi i gjithmbarshëm për muaj: € 3,360 | | |
| Pensione nga jashtë | 12 | | Transferi i gjithmbarshëm për muaj: € 4,510 | | |

Dërgues të remitancave rreth 71

Transferi i gjithmbarshëm për muaj: € 15,852,88

Supozimi është se 71 meshkujt e rritur që jetojnë jashtë vendit që kanë anëtarë të familjes në fshat vazhdojnë të dërgojnë remitanca. Paga e tyre mesatare (sipas anketës) është €1,488.57 në muaj. Nëse ata do të dërgonin rreth 15 % çdo muaj, ashtu siç supozon FMN në kalkulimet e veta, shuma e remitancave do të arrinte €223.28. Kjo përputhet me shumën e remitancave të pranuar nga ekonomitë familjare rurale, sipas Anketës së Buxhetit të Ekonomive Familjare 2003/4.

Tabela: të hyrat mujore nga puna në Cërrcë

| | Vende pune | Të hyrat mesatare për muaj (€) | Gjithsej në muaj (€) |
|----------------------------|---------------|-----------------------------------|-------------------------|
| Punë sezonale dhe në fermë | 62 | 121 ⁹³ | 7,502 |
| Vetëpunësim | 35 | 345 ⁹⁴ | 12,075 |
| Punësim privat | 48 | 280 ⁹⁵ | 13,440 |
| Kompani publike/NSH | 18 | 206 ⁹⁶ | 3,708 |
| OJQ/ON | 11 | 324 ⁹⁷ | 3,564 |
| Administratë publike | 55 | 167 ⁹⁸ | 9,185 |
| Gjithsej | 229 | 216 | 49,474 |

Tabela: transferet mujore dhe të hyrat tjera në Cërrcë

| | Të hyrat | Të hyrat mesatare për muaj (€) | Gjithsej në muaj (€) |
|------------------------------------|------------|-----------------------------------|-------------------------|
| Punësimi | 229 | 216 | 49,474 |
| Ndihma sociale (buxheti i Kosovës) | 29 | 62 | 1,798 |
| Pensione të Kosovës | 80 | 42 | 3,360 |
| Pensione nga jashtë | 12 | 376 | 4,512 |
| Remitanca | 71 | 223 | 15,833 |
| Gjithsej | 520 | 144 | 74,977 |

66 % të të ardhurave gjenerohen me punë, ndërsa 34 % vijnë nga transferet. Nga shuma e gjithmbarshme e transfereve (€ 25,503), vetëm 7 % janë ndihmë sociale dhe 13.2 % janë pensione lokale. Nga të ardhurat e gjithmbarshme, transferet publike të Kosovës zënë vetëm 6.9 %. 79.8 % të totalit janë remitanca: 62.1 remitanca nga punëtorët aktualë dhe 17.7 % nga pensionet nga jashtë.

⁹³ Në bazë të 18 përgjigjeve.

⁹⁴ Në bazë të 20 përgjigjeve.

⁹⁵ Në bazë të 35 përgjigjeve.

⁹⁶ Në bazë të 17 përgjigjeve.

⁹⁷ Në bazë të 7 përgjigjeve.

⁹⁸ Në bazë të 51 përgjigjeve.

SHTOJCA II – LUBISHTA NË SHIFRA (2005)

| | | | |
|--------------------------------------------|-------|-----|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Popullsia e gjithmbarshme | 2,134 | | |
| Popullsia rezidente | 1,543 | | |
| Rezidentë gjetiu në Kosovë | 19 | | |
| Jashtë vendit | 572 | 414 | Zvicër |
| | | 79 | Gjermani |
| | | 31 | Austri |
| | | 35 | Shtete të Bashkuara |
| | | 13 | shtete tjera (Francë, Itali, Slloveni dhe Belgjikë) |
| Gjithsej ekonomi familjare | 227 | 34 | të gjithë anëtarët jetojnë jashtë vendit |
| | | 5 | gjetiu në Kosovë |
| | | 88 | në Lubishtë me disa anëtarë jashtë vendit |
| | | 100 | në Lubishtë pa anëtarë jashtë vendit |
| Madhësia mesatare e ekon. familjare | 9.5 | | (përfshirë anëtarët jorezidentë) |
| Mosha e banorëve rezidentë | | 628 | 1-15 vite |
| | | 842 | 16-64 vite |
| | | 73 | 65 dhe më të vjetër |
| | | 0 | mosha nuk dihet |
| Popullsia e moshës së punës | 842 | | |
| | | 407 | Meshkuj 131 punojnë |
| | | 435 | Femra 2 punojnë |
| Meshkuj dhe femra që punojnë | 133 | 40 | Në fermë (që fitojnë para) |
| | | 38 | Sektor privat |
| | | 26 | Administratë publike |
| | | 19 | Punë sezonale |
| | | 9 | Ndërmarrje shoqërore/Ndërmarrje publike |
| | | 1 | Organizata ndërkombëtare |
| Vendet e punës në sektor privat | 38 | | |
| | | | 2 në servise të veturave në Ramnishtë dhe Lubishtë |
| | | | 4 në ndërtimtari (3 të kualifikuar për xhamprerës, hidraulik dhe instalime të rrymës) |
| | | | 4 në dy zdrukhtari |
| | | | 9 vozitës taksi |
| | | | 11 në gjashtë shitore |
| | | | 1 në tregtim të materialit ndërtimor |
| | | | 1 tek një stërshitës i veturave të përdorura |
| | | | 1 shitës i teknikës së bardhë |
| | | | 1 butik |
| | | | 8 në katër restorante në Viti dhe Klllokot (Qebaptore, Kalaja, Kulla dhe Hevi) dhe një në klub biliardoje në Viti. |
| Asistenca sociale | 38 | | familje (me gjithsej rreth 167 anëtarë) |
| | | | Transferi i gjithmbarshëm për muaj: € 2,386 |
| Pensione të Kosovës | 74 | | Transferi i gjithmbarshëm për muaj: € 3,108 |
| Pensione nga jashtë | 5 | | Transferi i gjithmbarshëm për muaj: € 2,668.75 |

Dërgues të remitancave rreth 156

Transferi i gjithmbarshëm për muaj: € 30,639,96

Supozimi është se të gjithë meshkujt e rritur që jetojnë jashtë vendit që kanë anëtarë të familjes në fshat vazhdojnë të dërgojnë remitanca. Paga e tyre mesatare (e deklaruar) është €1,309.37 në muaj. 15 % e kësaj shume është €196,41. Në këtë rast transferet e gjithmbarshme do të ishin €30,639.96.

Tabela: të hyrat mujore nga puna në Lubishtë

| | Vende pune | Të hyrat mesatare për muaj (€) | Gjithsej në muaj (€) |
|----------------------------------|------------|--------------------------------|----------------------|
| Punë sezonale dhe në fermë | 59 | 114 ⁹⁹ | 6,726 |
| Vetëpunësim | 33 | 125 ¹⁰⁰ | 4,125 |
| Punësim privat | 5 | 118 ¹⁰¹ | 590 |
| Kompani publike/NSH | 9 | 144 ¹⁰² | 1,296 |
| OJQ/ON | 1 | 350 ¹⁰³ | 350 |
| Administratë publike | 26 | 153 ¹⁰⁴ | 3,978 |
| Gjithsej të hyra nga puna | 133 | 128 | 17,065 |

Tabela: transferet mujore dhe të hyrat tjera

| | Të hyrat | Të hyrat mesatare për muaj (€) | Gjithsej në muaj (€) |
|-------------------------------------------------|------------|--------------------------------|----------------------|
| Punësimi | 133 | | 17,065 |
| Ndihma sociale (buxheti i Kosovës) | 38 | 63 | 2,394 |
| Pensione të Kosovës | 74 | 42 | 3,108 |
| Pensione nga jashtë | 5 | 534 | 2,670 |
| Remitanca | 156 | 196 | 30,576 |
| Gjithsej të hyra nga puna dhe transferet | 406 | 137 | 55,813 |

Vendet e punës gjenerojnë 30.5 % të të gjitha të hyrave në para të gatshme, ndërsa transferet 69.5 %. Nga shuma e gjithmbarshme e transfereve (€ 38,803) 6.2 % janë ndihmë sociale; 8 % janë pensione të Kosovës. Remitancat përbëjnë 85.9 % të të gjitha transfereve: 79 % janë remitanca të punëtorëve, ndërsa 6.9 % janë pensione nga jashtë.

⁹⁹ Në bazë të 7 përgjigjeve të punëtorëve sezonale. Fermerët nuk kanë deklaruar të hyra në para të gatshme. Sipas Anketës së Buxheteve të Ekonomive Familjare Bujqësore, mesatarja e të hyrave të parave të gatshme për një fermer është negative (d.m.th. fermerët e Kosovës shpenzojnë më shumë para të gatshme në plehra dhe derivate se sa që inkasojnë nga shitjet në treg).

¹⁰⁰ Në bazë të 17 përgjigjeve.

¹⁰¹ Në bazë të 4 përgjigjeve.

¹⁰² Në bazë të 9 përgjigjeve.

¹⁰³ Në bazë të një përgjigjeje.

¹⁰⁴ Në bazë të 26 përgjigjeve.

SHTOJCA III – NJË FSHAT I PASUR DHE NJË I VARFËR

Tabela: Të hyrat në para të gatshme në dy fshtrat

| | Lubishtë | | Cërrcë | |
|-------------------------|---------------------|--------------|---------------------|--------------|
| | Të hyra në muaj (€) | % | Të hyra në muaj (€) | % |
| 1. Asistencë sociale | 2,394 | 4.3 | 1,798 | 2.4 |
| 2. Pensione të Kosovës | 3,108 | 5.5 | 3,360 | 4.5 |
| 3. Pensione nga jashtë | 2,670 | 4.8 | 4,512 | 6.0 |
| 4. Remitanca | 30,576 | 54.8 | 15,833 | 21.1 |
| 5. Veprimtari ekonomike | 17,065 | 30.6 | 49,474 | 66.0 |
| Gjithsej | 55,813 | 100.0 | 74,977 | 100.0 |
| Për kokë banori | 36 | | 57 | |

Remitancat përbëjnë gati 55 % të të hyrave në para të gatshme në Lubishtë. Pesë pensione nga jashtë përbëjnë 5 % tjera të të hyrave në fjalë.

Në Cërrcë, të hyrat nga remitancat kanë rënë në 21 % të të hyrave në para të gatshme. Nuk është befasuese se 12 pensione nga jashtë gjenerojnë më shumë të hyra se sa 80 pensione të Kosovës.

Të hyrat për kokë banori në Cërrcë janë bindshëm më të larta se në Lubishtë.

Asistenca sociale luan rol të vogël në dy fshatrat.

SHTOJCA IV – METODOLOGJIA E HULUMTIMIT TË FSHATRAVE

Qëllimi ynë me këto studime të thukëta të dy rasteve të ndryshme ishte që të analizohen burimet dhe llojet e të hyrave të parave të gatshme në një zonë relativisht të përparuar dhe një relativisht të varfër të Kosovës. Një tjetër qëllim ishte të kuptojmë se çfarë lloje të vendeve të punës janë krijuar në Kosovën e pasluftës, cili është prospekti për krijimin vendeve të punës për popullsinë rurale, si dhe përmasat, natyrën dhe ndikimin e migrimit. Gjatë këtij hulumtimi, ndryshimi i strukturës së ekonomive familjare u shndërrua në temë bosht të tij sepse ishte kyçe për të kuptuar problemet me të cilat përballen fshatrat. Për të nxjerrë të dhëna të qëndrueshme në dy fshatrat në fjalë u kryen anketa derë më derë, në bashkëpunim të ngushtë me anëtarët e këshillave përkatës të fshatrave. Anketa u lansua në pranverë të vitit 2004 ndërsa u analizua dhe përfundua në vitin 2005.

Pyetësi i ESI kishte 44 pyetje (shih më poshtë). Të dy fshatrat janë vizituar nga disa herë prej ekipeve hulumtuese të ESI. Në Cërrcë dhe Lubishtë u vizituan harta të detajuara dhe u grumbulluan të dhëna derë më derë.

Në fillim të vitit 2005, përgjigjet u analizuan për të vërtetuar konsistencën dhe u shfrytëzuan për të identifikuar pyetje tjera për hulumtim. Hulumtuesit e ESI më pas vizituan shumë familje dhe prijës të fshatrave, duke i korigjuar të dhënat e anketës dhe duke grumbulluar informata të mëtejme kualitative. Të dhënat iu paraqitën liderëve lokalë për të kontrolluar gabimet evidente dhe për të marrë vlerësimet e tyre. Bashkëpunimi me fshatarë ishte në nivel të lartë. Në rastin e Lubishtës, prijësi i fshatit dhe një aktivist vizituan çdo familje dhe u ndihmuan atyre në mbushjen e formularëve. Në rastin e Cërrcës, prijësi i fshatit grumbulloi këshillin e fshatit dhe i shpërndau formularët tek përfaqësuesit e çdo mëhallë. Askush nuk u pagua për pjesëmarrje në hulumtim dhe nuk u ofrua asnjë mekanizëm motivues shtesë përtej ndikimit moral të anëtarëve të këshillave të fshatrave.

Marrja e përgjigjeve në 44 pyetje nga mbi 4,000 individë (1,980 në Cërrcë dhe 2,134 në Lubishtë) ishte sfidë e vërtetë. Në rastet kur nuk ishte i pranishëm asnjë anëtar i ekonomisë familjare, informatat bazike na siguroheshin nga fqinjët dhe anëtarët e këshillave të fshatrave (numri i anëtarëve të ekonomisë familjare, emrat, vendbanimi aktual).

Ka boshllëqe në rastet kur të gjithë anëtarët e familjes janë jashtë vendit. Në Cërrcë nuk kemi arritur të dimë gjininë e 27, emrat e 109, vendlindjen e 142 dhe nivelin e shkollimit të 534 personave. Në Lubishtë, në anën tjetër, kemi pasur më pak mungesa të informatave: moshën nuk e mësuam në vetëm 3 raste, përderisa 202 nuk iu përgjigjën pyetjes lidhur me nivelin e shkollimit. Kundërthëniet në përgjigje janë kontrolluar dhe disa pyetje janë përsëritur. Një arsye për mungesë të të dhënave ishte mosprezenca e familjeve të tëra, në të cilat raste të tjerët nuk i dinin të gjitha përgjigjet. Në të shumtën e rasteve, këto mangësi në të dhëna nuk kanë rëndësi statistikore. E vetmja fushë në të cilën informatat nuk ishin të plota ishte ajo e nivelit të remitançave të rregullta, për çka disa ekonomi familjare hezitonin të flasin.

Pyetësi kishte gjithsej 44 pyetje:

Pyetjet lidhur me marrëdhëniet familjare, emrat dhe mbiemrat, vendet e lindjes, moshën dhe vendbanimin:

- Cila mëhallë
- Cilat shtëpi
- Cila është marrëdhënia me kryefamiljarin
- Vendi i lindjes
- Vendbanimi
- Mosha

Pyetjet lidhur me shkollimin, punësimin dhe të ardhurat lokale:

- Shkollimi, analfabetizmi
- Profesioni
- Vendi i punës

Të hyrat mujore nga puna
 Të hyrat mujore nga puna sezonale
 Të hyrat nga shitja e produkteve të fermës
 Pensioni lokal mujor
 Ndihma sociale
 Pensionet

Pyetjet lidhur me migrimin:

Viti i migrimit
 Posedimi i lejes së rregullt të punës
 Statuset tjera civile (refugjat, azilkërkues, ilegal)
 Viti i kthimit vullnetar
 Viti i kthimit të detyruar

Pyetjet lidhur me transferet dhe remitancat nga diaspora (dhe komuniteti ndërkombëtar):

Kapitali fillestar për ndërmarrës
 Pensione nga jashtë
 Remitanca aktuale
 Niveli i remitancave në krahasim me vitin paraparak
 Niveli i remitancave në krahasim me periudhën para luftës
 Transferet për blerje të veturave
 Transferet për blerje të traktorëve
 Transferet për ndërtim të shtëpive
 Transferet për rindërtim të shtëpive
 Ndihma ndërkombëtare për rindërtim të shtëpive
 Transferet për investime në bujqësi

Pyetjet lidhur me pronën, pronësinë, infrastrukturën:

Kompani
 Automobil
 Traktor
 Shtëpi
 Shtëpi gjetiu
 Sipërfaqja e tokës
 Pronësia mbi tokën
 Lopë
 Pula
 Dele
 Stallë
 Infrastrukturë